

# Dëlirje & Edukim

KORRIK 2005 / REXHEB 1430 / NR. 3 / QMIMI 1 €

REVISTË MUJORE FETARE EDUKATIVE KULTURORE SHKENCORE

- Besimi
- Pejgamberi ynë dhe shokët e tij
- Komentime nga Kur'ani
- Hadith
- Jurisprudencë
- Dëlirje & Edukim
- Familja
- Minberi
- Pyetje dhe përgjigje
- Kolosët e Umetit
- Tema

"Umeti ngritjen e fesë mund ta arrigë me anë të tevhidit dhe unitetit, duke u bashkuar në të dhe në këtë mënyrë dallohet nga idhujtaria dhe idhujtarët. Mëqençse kjo nuk mund të bëhet vetëm se përmes zgjedhjes, mëshirës dhe udhëzimit nga ana e Allahut të Madhërishtëm, Allahu i Lartësuar thotë: "Ata vazhdimisht janë në kundërshtim (mes vese), përveç atij që e mëshiroi Zoti yt." Mirëpo, ky umet nuk mund ta realizojë ngritjen e fesë pa zbatuar çështjen e referimit të dijetarët e vet..."  
(KËSHILLËT PËR NGRITJEN E FESË)  
fq. 34

## Kremtimi i Israsë dhe Miraxhit

"Çdo gjë që është e transmetuar për këtë natë (d.m.th. për caktimin se në cilën natë dhe muaj ka ndodhur, pra kremtimi i saj) nuk është e vërtetë dhe nuk është e njohur tek dijetarët e hadithit. Pa dyshim që moscaktimi i kësaj nate është urtësi e Allahut, po edhe sikur ta caktonte, nuk do t'u lejohej muslimanëve që ta veçojnë atë me diçka prej adhurimit dhe për këtë arsye edhe nuk u lejohej festimi i saj, pasi Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem nuk e ka praktikuar dhe as sahabët e tij nuk e kanë veçuar me diçka të veçantë."

(KREMTIMI I ISRASË DHE MIRAXHIT) fq. 47

### Këshilla e muajit

"Sot jua përsosja fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush, dhe zgjodha që islami të jetë feja juaj"

Molde, 3



*Kryeredaktor:*  
Zejd Haziri

*Anëtarët e revistës:*  
Unejs Murati  
Fidan Xhelili  
Xheladin Leka

*Bashkëpunëtorët:*  
Muhamed Abdullahi  
Sabahudin Selimi  
Bali Sadiku

*Redaktor gjuhësor:*  
Arian Koçi

*Redaktor Teknik:*  
Avni G. Gashi

*Ballina/Dizajni:*  
Avni G. Gashi

*Boton:*  
Shtëpia botuese  
**Atik**

Gjilan, Republika e Kosovës

*Tirazhi: 1000*

Adresa:  
Rr. M. Idrizi p.n 60000 Gjilan  
Republika e Kosovës  
Tel: 044 988 400  
e-mail:  
delirjedheedukim@gmail.com

## PËRMBAJTJA

<b>EDITORIALI</b> .....	2
Ty, që dhimbja jote është e imja .....	2
<b>BESIMI</b> .....	3
Besimi i Muslimanit Sunij (3) .....	3
Emërtimet e shkencës së Besimit .....	4
Argumentet e të krishterëve për trinitetin .....	11
<b>PEJGAMBERI YNË DHE SHOKËT E TIJ</b> .....	14
Ebu Bekër Es-Siddiku .....	14
<b>KOMENTIME NGA KUR'ANI</b> .....	22
Bekare 21-22 .....	22
<b>HADITH</b> .....	23
Kontributi i sahabëve për ruajtjen e Sunetit .....	23
Parathënia e "Sunetit" të ibën Maxhes .....	27
<b>JURISPRUDENCË</b> .....	30
Hyrje në shkencat e fikhut (II) .....	30
<b>DËLIRJE &amp; EDUKIM</b> .....	34
Kushtet për ngritjen e fesë .....	34
<b>FAMILJA</b> .....	35
Sistemi familjar në Islam (III) .....	35
<b>MINBERI</b> .....	39
Mënyra e trajtimit të risive në Fe - Bidatet (II) .....	39
<b>PYETJE &amp; PËRGJIGJE</b> .....	43
Vendimi i zekatit në Islam .....	43
Performancat e zekatit në shoqëri dhe ekonomi .....	44
<b>KOLOSËT E UMETIT</b> .....	45
Muhamed ibën Salih el-Uthejmin, jeta dhe vepra e tij .....	45
<b>TEMA</b> .....	47
Kremtimi i Israsë dhe Miraxhit .....	47

# TY, QË DHIMBJA JOTE ËSHTË EDHE E IMJA

**N**ga mirësitë që Allahu na ka dhuruar është edhe bashkimi në lidhjen më të fortë, në lidhjen më të përsosur, lidhje që na bashkon në dashurinë për Allahun, lidhje që interesat e tjera i bën të pavlera, lidhje që nuk shpëputet lehtë, por gjithmonë është aktive në gëzime dhe fatkeqësi, lidhje për të cilën na kanë zili të gjithë ata që e kanë humbur. Kjo lidhje është ajo për të cilën Allahu në Kur'an thotë: **“Me të vërtetë, besimtarët janë vëllezër...”** Huxhurat: 10.

Fatkeqësitë, muslimani duhet t'i kalojë me durim, me lutje drejtuar Allahut, që ajo goditje të tejkalohet në mënyrat me të cilat Allahu është i kënaqur.

Me të vërtetë që çdo gjë të keqe që e godet besimtarin, atë e ndien edhe vëllai i tij në fe, i afërt qoftë apo i largët. Si të mos të jetë kështu, kur Muhamedi sal-Allahu alejhi ve sel-lem ka thënë se muslimanët duhet të jenë si një trup i vetëm; nëse atë e godet diçka, duhet që atë goditje ta përjetojnë të gjithë, ashtu si shembulli i trupit të njeriut, që kur ankon nga një dhimbje, e ndien i tërë trupi. Muslimani i devotshëm duhet që gjënë të cilën e do për vete t'ia dojë edhe vëllait të tij dhe anasjelltas, atë që e urren për vete ta urrejë edhe për vëllanë e tij. Me këtë veprim arrihet kulminacioni i dashurisë për Allahun, si rezultat i së cilës është kënaqësia e Allahut. Pa dyshim se kjo botë nuk është e rrethuar vetëm me të mira, por krahas të mirave Allahu bëri që njeriu të shijojë edhe të këqijat. Këto të këqija janë të tilla në syrin tonë, mirëpo Allahu ato i caktoi me ndonjë urtësi, që gjithsesi janë në të mirë të njeriut, si shembulli i ilaçit; mund të jetë i hidhur, por

është në dobi të njeriut. Si të mirat ashtu edhe të këqijat muslimani i trajton me një trajtim të veçantë, të panjohur kurrë më parë nga ndonjë doktrinë. Ky trajtim bazohet në thënien e Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë: “Është çudi çështja e besimtarit, e tërë ajo është e mirë për të. Nëse e godet ndonjë fatkeqësi, bën durim dhe ka shpërblim tek Allahu. E, nëse Allahu e gëzon me diçka, e falënderon Atë dhe ka shpërblim tek Ai.”

Derisa jetojmë, do të sprovohemi. Shpresojmë tek Allahu që të kemi durim, por sprovave e madhe pa dyshim është ajo pas vdekjes.

Mbetemi me shpresë tek Allahu që të na pastrojë nga mëkatet përmes sprovave, që sprovën e madhe, domethënë vdekjen, ta kalojmë si është më së miri.

Dhe lutja jonë e fundit është: falënderimi i takon Zotit të botëve!

*Unejs Murati*

## BESIMI I MUSLIMANIT SUNNIJ SIPAS KUR'ANIT TË SHENJËT, HADITHIT TË SAKTË PEJGAMBERIK DHE RRUGËS SË TË PARËVE TANË TË MIRË (3)

### 16. Cili është shirku i madh?

Çdo adhurim që kryhet për ndokënd tjetër përveç Allahut, si: lutja, zotimi, kurhani, etj.

Allahu thotë në Kur'an: "Thuaj (o Muhamed): 'Unë lus vetëm Zotin tim (Allahun Një dhe të Vetëm) dhe nuk bashkoj askënd si shok a të barabartë bashkë me Të.'" Xhinn: 20

Muhamedi, sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Mëkati më i madh është shirku ndaj Allahut." Buhariu

### 17. Cilat janë dëmet nga shirku i madh?

Shirku i madh është shkak për qëndrimin e përhershëm në zjarr të xhehenemit.

Allahu i Lartësuar thotë: **"..nuk ka dyshim se kushdo që i vë shok në adhurim Allahut, atëherë Allahu e ka bërë haram (të ndaluar) xhenetin për të dhe vendbanimi i tij do të jetë zjarri...."** Maideh: 72

Muhamedi, sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Kush vdes duke i shoqëruar Allahut diçka në adhurim, do të hyjë në zjarr." Muslimi

### 18. A i sjell dobi vepra personit me praninë e shirkut të madh?

Asnjë vepër nuk sjell dobi me praninë e shirkut të madh.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Ky është udhëzimi i Allahut, me të cilin Ai udhëheq këdo nga robërit e Tij. Po sikur ata të kishin bashkuar të tjerët në adhurimin e Allahut (t'i kishin vënë shok Allahut në adhurim) gjithçka që ata kanë punuar do të kishte qenë pa asnjë vlerë për ta."** En-Aam: 88

**"Dhe Ne i kthehemi çfarëdo lloj pune që e bënë ata (mosbesimtarët) dhe do t'i bëjmë veprat e tilla si grimca pluhuri që fluturojnë në hava (qiell)."** [Furkan: 23]

Allahu thotë në një Hadith Kudusij: "Kush bën një vepër në të cilën më shoqëron dikë Mua, e

kam lënë atë dhe shirkun e tij." Muslimi

### 19. A është shirku i pranishëm te muslimanët?

Po, është i pranishëm, madje shumë, fatkeqësisht! Allahu thotë në Kur'an: **"Dhe shumica e tyre nuk e besojnë Allahun, veçse duke i bashkuar Atij shokë e ortak si të barabartë me Të (duke u bërë mushrikë (idhujtarë))."** Jusuf: 106

Muhamedi, sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Nuk do të ndodhë kiameti derisa disa nga fiset e popullit tim të pasojnë çifutët dhe të adhurohen idhujt." Tirmidhiu; sahih

### 20. Cila është dispozita e shariatit për atë që i thotë muslimanit kafir (jobesimtar) pa pasur argument?

Kjo gjë nuk lejohet, madje është nga mëkatet e mëdha.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Thuaj: "(Por në të vërtetë) gjërat që i ka ndaluar Zoti im janë El Fahisha (gjynahet e mëdha, çdo lloj afrimi me gratë jashtë martesës, etj.) që kryhen hapur ose fshehur, gjynahet (e tjera të çdo lloji), shtypja pa të drejtë, vënia shok Allahut në adhurim (adhurimi i të tjerëve përkrah a përveç Atij), gjë për të cilën Ai nuk ka dhënë asnjë të drejtë e asnjë provë, si dhe përfolja për Allahun për gjëra të cilat ju nuk keni asnjë dijeni."** A'rafë: 33

**"Thuaj: "Sillni argumentet tuaja nëse jeni të sinqertë."** El Bekare: 111

Muhamedi, sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Kush i thotë vëllait të vet kafir (jobesimtar), vetëm se e ka merituar njëri prej tyre."

# EMËRTIMET E SHKENCËS SË BESIMIT

**Emrat e shkencës së besimit ndahen në emra të ligjshëm dhe jo të ligjshëm (të shpikur)**

*Emrat e ligjshëm të shkencës së besimit*

## 1. *Es-Sunneh (Sunneti)*

Es-suneh në etimologji do të thotë rrugë që ndiqet, qoftë ajo e mirë apo e keqe.

Ndërsa në terminologji fjala es-suneh përkufizohet në bazë të shkencës në të cilën hulumtohet. Për shembull:

a) Në shkencën e besimit me fjalën sunnet synohet rruga në të cilën ka qenë i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem, halifët e drejtë pas tij dhe të parët e devotshëm në çështje të besimit para se të shfaqeshin risitë dhe mendimet e devijuara.

Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Shprehja sunnet te pararendësit e devotshëm ndërthen në vete sunetin në adhurime dhe çështje të besimit, edhe pse shumë prej atyre që kanë shkruar me fjalën sunet kishin për qëllim atë në çështje të besimit, si p.sh. fjala e Abdullah ibën Mes'udit, Ubej ibën Ka'bit dhe Ebu Derdas, Allahu qoftë i kë-

naqur me ta, të cilët thanë: "Të mjaftuarit në Sunnet është më mirë sesa të munduarit në bidat."<sup>[1]</sup>

Në këtë aspekt është edhe fjala e imam Sufjan ibën Ujejnes, Allahu e mëshiroftë, i cili thotë: "Sunneti janë dhjetë gjëra. Tek ai që gjenden këto, e ka plotësuar Sunnetin, kurse ai që lë diçka prej tyre vetëm se e ka lënë Sunnetin: besimi në kaderin (caktimin e Allahut), dhënia përparësi Ebu Bekrit dhe Omerit, besimi në havdin,<sup>[2]</sup> ndërmjetësimin (shefatin), peshoren (mizanin), besimi në rrugën e sir-atit, thënia se imani është fjalë dhe vepër, Kur'ani Fisnik është fjalë e Allahut, ringjallja në Ditën e Gjykimit dhe mosdëshmia e prerë për askënd prej muslimanëve se është martirizuar."<sup>[3]</sup>

Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Sa i përket Sunetit -në të cilën jam unë dhe i kam parë shokët tanë në të prej pasuesve të hadithit dhe unë e kam marrë nga ata, si: Sufjani, Maliku e të tjerë -është dëshmia se askush nuk meriton të adhurohet pos Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij dhe se Allahu qëndron mbi Arshin e Tij në

[1] El-Lalekai në "Sherh usul i'tikad ehli sunneti vel xhema'a", nr. 10, 13, 14, 114, 115. "El-Istikameh" (2\310-311).

[2] Gjuhësisht do të thotë lloj baseni apo liqen i madh dhe fjala është për ujin ku do të pinë banorët e xhenetit.

[3] El-Lalekai (316).

qiell, afrohet te krijesat e Tij qysh Ai do dhe zbret në qiellin e kësaj bote qysh Ai do... "[4] Imam Ebu Bekër El-Humejdi thotë: "Sunneti tek ne do të thotë që njeriu të besojë në kaderin (caktimin) të mirën dhe të keqen, ta dijë se ajo që i ka ndodhur nuk kishte se si mos t'i ndodhte dhe ajo që nuk i ka ndodhur nuk kishte se si t'i ndodhte dhe e tërë kjo është caktim prej Allahut të Madhërishëm." [5]

Dhe për këtë janë shtuar shkrimet e dijetarëve të Ehlu Sunetit të ashtuquajtura me emrin "Es-Suneh". Në mesin e atyre që kanë shkruar kanë qenë imam Ahmedi, djali i tij Abdullahu, imam Kermanij, imam El-Halali, imam Ibën Ebi Asimi dhe imam Muhamed ibën Nasër el Mervezij, Allahu i mëshiroftë.

Kishte prej shkrimeve të tyre që i titullonin Usul es-Suneh, Bazat e Sunetit, siç ishte libri i imam el Humejdit dhe i imam ibën Ebi Zemenejnit dhe të tjerë.

Kishte të atillë që i titullonin librat e tyre me emrin Sherh es-Suneh, ose Sqarimi i Sunetit, siç bëri këtë imam el Muzeniu dhe imam el Barbaharij dhe të tjerë, Allahu i mëshiroftë .

b) Te dijetarët e hadithit fjala sunet aludon atë që tregohet nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem prej fjalëve, veprave, pëlqimeve, cilësive të trupore apo etike para shpalljes apo edhe pas saj.

Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Sunnet do të thotë kur argumentet tregojnë për një gjë se ajo është nënshtrim ndaj Al-

lahut dhe të Dërguari të Tij, pa marrë parasysh a e ka vepruar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem apo është vepruar në kohën e tij, apo edhe nëse nuk e ka vepruar ai e as nuk është vepruar në kohën e tij për shkak të moskrijimit të kushteve apo për shkak të ndonjë pengese." [6]

c) Te dijetarët e fikhut (juristët) me fjalën sunnet synohet ajo që është e ngjashme me të pëlqeshmen, të preferuarën dhe është e kundërta e farzit, obligimit. Gjithashtu është njëra ndër rregullat e sheriatit me të cilat obligohemi.

d) Te dijetarët e shkencës së usulit me të nënkuptohet ajo që ka ardhur nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem jashtë Kur'anit dhe është bazamenti i dytë legjislativ.

Ndërsa në sheriat, kur përmendet fjala sunnet, është për qëllim kuptimi i gjerë, përfshin tërë udhëzimin e të Dërguarit të Allahut dhe të shokëve të tij, duke futur këtu fjalët, veprat dhe bindjet, çështjet e besimit.

Për këtë aludon fjala e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "Kush e kundërshton Sunnetin tim, ai nuk është prej meje." [7] Dhe: "Kapuni për Sunnetin tim dhe të udhëheqësve të drejtë (halifëve) e të udhëzuar pas meje." [8]

Imam Ebu el Hasen el-Kerexhi, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Dije se Sunneti është rruga e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, të kapurit për të. Ajo është në tri pjesë: fjalë, vepra dhe besim." [9]

[4] Ibën Kajjimi e ka përmendur në librin e tij "Ixttima xhujush el muslimin", faqe 59.

[5] "Usul es-sunneh", faqe 47-48.

[6] "Mexhmu fetava" (21\317), shiko edhe "Minhaxhu es-suneh en-nebevije" (3\457-458).

[7] Buhariu (5063), Muslimi (1401).

[8] Ahmedi (4\12), Ebu Davudi (4608), Tirmidhiu (2676), Ibën Maxheh (42), Ibën Hibani (5---ihsan), Ibën Ebi Asim në "Es-suneh" (54). E ka bërë të saktë dijetari ynë Muhamed Nasirudin Albani në "es-Sahiha" (937) dhe në "Irvaul galil" (2455).

[9] E ka treguar në "Mexhmu fetava" (4\180).

Ndërsa imam Ebu Nasër es-Sixhzij, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Fjala jonë "kështu është Sunneti i Resulullahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem" nënkupton rrugën e tij dhe në të cilën ai ka thirrur, që të kapemi për të."<sup>[10]</sup> Hoxha i Islamit Ibën Tejmije thotë: "Sunneti është ajo në të cilën ishin Resulullahu dhe shokët e tij, si në bindje (besim), fjalë dhe vepër."<sup>[11]</sup>

Imam Ibën Rexheb el-Hanbelij, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Sunneti është rruga e trasuar dhe përfshin kapjen pas asaj në të cilën ka qenë Pejgamberi dhe halifët e drejtë në çështje të besimit, në vepra dhe fjalë. Ky është Sunneti i përkryer dhe i plotë. Dhe për këtë arsye, kur selefi përmendnin fjalën sunnet, nuk synonin tjetër pos kësaj që përmendëm."<sup>[12]</sup>

## 2) *Esh-sheria - sheriati-legjislacioni, ai është çka Allahu bëri ligj për robërit e Tij prej fesë.*<sup>[13]</sup>

Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Fjala sunnet është si ajo shariat, sepse fjala shariat (ligj) është ajo që Allahu e ka bërë ligj. Ndodh që ajo që Allahu ka bërë ligj të jetë prej besimit, ndodh që të jetë prej veprave dhe ndodh të jenë për qëllim që të dyja së bashku." Pra, fjala sunet përdoret edhe në kuptim të shariatit, ligjit, prandaj edhe Ibni Abasi, kur komenton fjalën e Allahut shir'aten ve minhaxhen - ligj e program, thotë: "Sunneten ve sebilen", d.m.th. e komentoit fjalën shir'aten-ligj me fjalën sunnet, ndërsa fjalën minhaxhen-program e komentoit me fjalën rrugë.

Emri i sunnetit dhe i shariatit ndodh të pë-

doren në çështje të besimit dhe në fjalë, por ndodh të përdoren në qëllime dhe vepra.<sup>[14]</sup> Imam el Axxhurrij shkroi librin e tij me emrin "Esh-sheria" e pas tij edhe imam Ibën Beta el Ukberij librin e tij me titull "El ibane an sheriatil firkati en-naxhije".

## 3. *El iman (besimi)*

Imani gjuhësisht do të thotë "el ikrar", pranim dhe "et tasdik", vërtetim, që të dyja të shoqëruara nga nënshtrimi. Ndërsa tek Ehlu Suneti dhe Xhemati përkufizimi i imanit është ky: "Besim me zemër, shqiptim me gojë, vepër me gjymtyrë, shtohet me nënshtrim ndaj Allahut, ndërsa pakësohet me nënshtrim ndaj shejtanit".

Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Ajo që transmetohet nga sahabët dhe imamët e tabiinëve dhe shumicës së pararendësve e ky është po ashtu drejtimi i pasuesve të hadithit. Ky mendim i dedikohet edhe Ehlu Sunetit, se imani është kavlun ve amelun- fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet, shtohet me adhurim dhe pakësohet me mëkat."<sup>[15]</sup>

Besimi emërtohet me emrin iman duke pas parasysh gjashtë bazat mbi të cilat ngrihet edhe besimi.

Prej librave të njohur me këtë emër janë:

"Kitabul iman ve mealimuhu ve sunenuhu ve istikmalu derexhatihi", i imamit Ebu Ubejd el Kasim ibën Sel-lam,

"El iman", i imamit Ebu Bekër ibën Ebi Shejbeh,

"Kitabul iman", i imam Ibën Mendes,

"Kitabul iman", i imam Muhamed ibn Jahja

[10] "Er-red ala men enkere el harfe ves-savt" (faqe 99).

[11] M'exhmu fetava" (5\111).

[12] Xhamiul "ulum vel hikem" (faqe 295).

[13] "En-Nihaje" e Ibën Ethirit (2\460).

[14] "Mexhmu fetava" (19\307-308).

[15] "Mexhmu fetava" (7\505).

el Adenij, Allahu i mëshiroftë të gjithë.

#### 4. Et-tevhid-njësimi i Allahut

Tevhid gjuhësisht do të thotë ta veçosh një gjë, ta bësh të vetme, ta njësosh. Në shariat apo në terminologji do të thotë veçimi, njësimi i Allahut në adhurim, bindje se Ai është i vetëm në qenien, veprat dhe cilësitë e Tij.<sup>[16]</sup>

Imam Ibën Kajjim el Xhevzije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "E vërteta e tevhidit është pranimi i cilësive të përkryera të Allahut, të lartësuarit e Allahut nga të kundërtat e tyre dhe adhurimi i Tij, të vetmit, që nuk ka shok."<sup>[17]</sup>

Ibën Tejmije thotë: E vërteta e tevhidit është që: "Të mos i shoqërohet asgjë Allahut në ato gjëra që janë prej veçorive të Allahut."<sup>[18]</sup>

Të emërtuarit e besimit me tevhid është nga këndi i emërtimit të një gjëje me një prej pjesëve të saj më të ndershme.<sup>[19]</sup>

Prej librave të besimit që janë quajtur me këtë emër janë:

"Kitabu et-tevhid ve ithbat sifât er-rab az-ze ve xhel-le", i imam Ibën Huzejmes.

"Kitabu et-tevhid", i imam Ibën Mendesit, Allahu i mëshiroftë.<sup>[20]</sup>

#### 5. Usulud-din- bazat e fesë

Kjo shprehje është përdorur nga disa dijetarë të pararendësve të parë, si imam Ibën Ebi Hatimi, i cili thotë: "E kam pyetur të atin dhe Eba Zur'an për mendimet e Ehlu Sunetit në usuluddin, çfarë kanë arritur ata nga dijetarët e tërë botës dhe çfarë bindjeje kishin

ata..."<sup>[21]</sup>

Pasuesit e bidateve kanë futur nën ombrellën e këtij emërtimi shumë nga bidatet dhe devijimet e tyre, pra ki kujdes mos të të mashtrojë kjo, sepse shumë prej bindjeve të këqija mbulohen me shprehje jo të qarta."<sup>[22]</sup> Hoxha i Islamit Ibën Tejmije thotë: "Një grup nga pasuesit e kelamit (apologjetikës) atë që kanë shpikur prej bidateve e kanë quajtur me këtë emër, usuluddin. Ky është emër i madh, ndërsa të quajturit me këtë emër i gjërave që s'janë prej saj është prej dëmit të madh, veç Allahu e di. E, në qoftë se dikush prej Ehlu Sunetit e kundërshton atë që ata kanë futur nga vetja (prej bidateve), atëherë thonë se po kundërshtojnë usuluddin - bazat e fesë. Ata nuk mohuan atë që e meriton të quhet usuluddin, por mohuan atë që kanë shtuar shpikësit. Ajo që kanë shtuar ata janë emra që i kanë vënë ata dhe prindërit e tyre, por Allahu nuk ka zbritur për to ndonjë argument. Fe është ajo që Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë bërë të ligjshme dhe Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem i ka qartësuar bazat e fesë dhe degët e saj. Është e pamundshme që Pejgamberi i Allahut t'i ketë sqaruar degët e fesë e të mos i ketë sqaruar bazat e saj, siç e kemi sqaruar këtë çështje në shumë vende"<sup>[23]</sup>

*6. Fik'hul ekber - fikhu i madh, përballë të cilit është fik'hul asgar, fikhu i rregullave praktike të shariatit. Është quajtur ekber-më i madh për arsye se fjala është për Allahun, i lartësuar është Ai.*

Është përhapur dhe është bërë e njohur nga

[16] Shiko "Levamiu el-envar" (1\57).

[17] "Es-savaik el mursele" (faqe 922).

[18] "Mexhmu fetava" (3\74).

[19] Pra, tevhidi është pjesë e besimit dhe më me vlerë (sh.p.).

[20] Gjithashtu libri i mirënjohur dhe shumë i dobishëm "Kitabu et-tevhid" i imamt të ndershëm Muhamed bin Abdul Vehab, Allahu e mëshiroftë (sh.p.).

[21] Transmeton El-Lalekai (31), Ebu Ala el Hemedhanij në "Futja fi dhkri el i'tikad" (30), Ibnu Kudame në "Ithbat el uluv"(125) dhe e ka vërtetuar Albani në "Muhtesar el uluv lil Alij El Adhim"(204). Shiko librin tonë "Ediletul vahjejn fi sherh akidet err-rrazijejn", (faqe 29-32).

[22] "El avasimu vel kavasim" i Ibnu Vezir el Jemanij (4\179).

[23] "Mexhmul fetava" (4\56).

imam Ebu Hanife, Allahu e mëshiroftë, se ka një libër në çështje të besimit të titulluar "Fik'hul ekber", por nuk vërtetohet me zinxhir të vërtetë se është libri i tij.

Dijetari i madh Salih el Fulanij thotë: "Emri fekih-jurist te pararendësit është përdorur për atë që di Kur'anin, Sunnetin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, fjalët e sahabëve dhe ata që erdhën pas tyre nga dijetarët e umetit. Kush është angazhuar me mendimet e njerëzve dhe i ka marrë ato për fe dhe program, e në anën tjetër Kur'anin, Sunnetin e të Dërguarit, gjykimet e sahabëve dhe të tabi'inëve i ka lënë anash, nuk i thuhet fekih, por më mirë është t'i thuhet i kapur pas epshit dhe tekave të tij."<sup>[24]</sup>

*7. El ilmiyat - çështjet teorike, e kundërta e saj janë el amelijat-çështjet praktike.*

## Emrat jo të ligjshëm të shkencës së besimit

1. Ilmul kelami-apologjetika; e vërteta e saj është vërtetimi i bindjeve të këqija me anë të logjikës, polemikës dhe në mënyrë filozofike. Hoxha i Islamit Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Polemika në çështjet e besimit quhet kelam."<sup>[25]</sup>

Ilmul kelami, apologjetika, është e ndërtuar në bazë të barazimit në polemikë dhe mendime me zotërinjtë e tyre prej filozofëve grekë. Pasuesit e kelamit në librat e tyre i quajnë dijetarët e tyre filozofë, njerëz të urtë dhe të mençur, librat e tyre janë të zhveshur nga citatat kur'anore, hadithet pejgamberike, gjurmët e selefrit tanë nga sahabët, të cilët dëshmuar zbritjen e shpalljes dhe besimi preku zemrat e tyre. Ata ishin shokët më të mirë të Pejgamberit më të mirë. Por pasuesit

e kelamit hynë edhe në çështje për të cilat sheriati ka heshtur, kurse gjërat për të cilat sheriati kishte treguar, ata i anashkaluan. Shkenca e kelamit, siç e kanë quajtur, ka hise shumë në emrin që mban sepse ajo me të vërtetë është vetëm kelam, fjalë që nuk bën dobi, por vetëm se i sëmur zemrat dhe mbjell në to dyshimin, mëdyshjet dhe mosbesimin. Ky emërtim është i kotë dhe i devijuar, por edhe fyes për besimin e pastër e të ndërtuar në argumente të kënaqshme, sepse mendimet e prishura, dyshimet e kota, paragjykimet e pista dhe shkallët e ulëta të çmendurisë nuk ngrihen te besimi i pastër i marrë nga Kur'ani i Lartë dhe nga fjala e Pejgamberit të mbrojtur sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "Thuaj, a barazohet i verbëri me atë që sheh, apo a barazohen errësirat me dritën (e Allahut)?"

Grupimet e ilmul kelamit janë:

1. Xhehmitë, pasuesit e Xhehëm ibën Safvan es-Semerkanidit (vdiq më 128 h).
2. Mu'tezilitë, pasuesit e Vasil ibën Ata' el Gaz-zalit (131 h) dhe Amër ibën Ubejdit (144).
3. Kulabitë, pasuesit e Abdullah ibën Kul-lab el Katanit (243 h).
4. Esh'aritetë, pasuesit e Ebul Hasen el Eshariut (324 h), para se të kthehej në drejtimin e selefrit në përgjithësi.
5. Maturiditetë, pasuesit e Ebu Mensur el Maturidij (333 h).

Imamëve e të katër medh'hebeve janë në ujdi për ndalimin nga kelami dhe në qortimin e tij.

-Nga Muhamed ibën Hasen esh-Shejbani

[24] "Ijkadh himem ulil ebsar" (faqe 28).

[25] "Der'u et-tearud" (1\160).

tregohet se Ebu Hanifja, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Allahu e mallkoftë Amër ibën Ubejdin sepse ai i ka çelur dyert e kelamit, e cila nuk iu bën dobi."<sup>[26]</sup> Muhamed ibën Haseni ka thënë se Ebu Hanifja na nxiste në mësimin e fikhut dhe na ndalonte nga kelami.<sup>[27]</sup>

Imami Ebu Jusufi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Kush e kërkon fenë me kelam, veçse është bërë zindik."<sup>[28]</sup>

Dhe ka thënë: "Të njohurit e polemikës dhe kelamit është padituri, ndërsa mosnjohja e polemikës dhe kelamit është dituri."<sup>[29]</sup>

Imam Maliku, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Nuk pranohet dëshmia e pasuesve të bidatit dhe tekave." Huvejzmindadi në lidhje me këtë fjalë të imam Malikut thotë: "Pasuesit e bidateve për imam Malikun ishin ata që merreshin me apologjetikë, prandaj çdo mutekel-lim (që merret me kelam) është prej pasuesve të bidatit, qoftë esh'arij apo jo, dhe nuk pranohet dëshmia e tij në Islam asnjëherë. Të tjerët duhet të distancohen nga ai dhe ai duhet të edukohet që të kthehet nga bidati i tij. E, nëse vazhdon, atëherë i kërkohej të pendohet."<sup>[30]</sup>

Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Kam lexuar diçka në lidhje me ata që janë marrë me apologjetikë. Për Allahun, s'kam besuar se muslimani i thotë ato fjalë! Sikur robi të sprovohej me tërë atë që e ka ndaluar Allahu, pos shirkut (idhujtarisë), do të ishte më mirë për të sesa të sprovohej me kelam."<sup>[31]</sup>

Imam Shafiu ka thënë: "Mendimi im për ata që merren me apologjetikë është të rrihen me shkopinj dhe nalle e të nxirren nëpër fise e t'u thuhet ky është shpërblimi për atë që e lë Kur'anin dhe Sunnetin e merret me apologjetikë."<sup>[32]</sup> Dhe ka thënë: "Mendimi im për ata që merren me apologjetikë është si mendimi i Umerit, Allahu qoftë i kënaqur me të, për Sabigun."<sup>[33]</sup> Dhe shton: "Kush merret me apologjetikë, nuk shpëton."<sup>[34]</sup>

Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Nuk jam ndjekës i apologjetikës dhe nuk e shoh atë në asnjë aspekt, përveç asaj që është në librin e Allahut apo në fjalën e të Dërguarit të Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ose nga sahabët apo tabiinët. Përveç kësaj, të folurit në të është jo i pëlqyer."<sup>[35]</sup>

Dhe ka thënë: "Përmbajuni Sunnetit dhe hadithit, Allahu ju bën dobi me të. Kini kujdes e mos u zhytni në polemikë dhe apologjetikë, sepse ai që e do atë nuk shpëton. Kush ka shpikur ndonjë fjalë të re, përfundimi i tij ka qenë në bidat, sepse apologjetika nuk të çon në të mirë, nuk e dua atë dhe të zhyturit në të e as polemikën. Përmbajuni Sunnetit dhe mësoni fikhun, me të cilin do të keni dobi, e lëreni polemikën dhe fjalët e pasuesve të së kotës. I kemi takuar njerëzit, nuk dinin për të asgjë dhe largoheshin prej pasuesve të apologjetikës. Allahu na ruajtë ne dhe ju nga fitnet dhe na shpëtoftë nga çdo shkatërrim!"<sup>[36]</sup> Dhe ka thënë: "Kush merr prej apologjetikës nuk shpëton dhe kush merr

[26] Transmeton Herevii në "Dhem-mul kelam ve ehlihi" (1029).

[27] E ka përmendur Ibën Tejmije në "Fetava el-kubra" (6\561).

[28] El Herevii (1009) dhe el Asbahaniu në "El huxheh" (1\106).

[29] Transmeton Herevii (1010).

[30] Transmeton Ibën Abdul Berri në "El Xhami" (2\96).

[31] Transmeton Bejhekiu në "Menakib esh Shafi'ij" (1\454) dhe Ibën Ebi Hatim në "Adab esh-Shafi'ij ve menakibuhu" (faqe 182).

[32] Herevii (1142), e ka treguar Ibën Xhevziyu në "Telbisul iblis" (faqe 65) dhe Ibën Tejmije në "Minhaxh es-suneh" (2\610) dhe "Der'u tearud" (1\232).

[33] Transmeton Herevii (720). Umeri si halife kishte fshikëlluar Sabigun për shkak të devijimit të tij.

[34] Transmeton Herevii (1152).

[35] Transmeton Abdullah ibën Ahmedi në "Es-suneh" (108).

[36] Transmeton Ibën Beta në "El Ibaneh" (2\539).

prej kelamit, nuk është çudi që bëhet xhehmij.”<sup>[37]</sup>

Dijetarët tanë, Allahu i mëshiroftë, kanë marrë përsipër që të qartësojnë gjendjen e keqe të tyre dhe rrugëtimin e tyre të paudhë, zbulimin e devijimeve të tyre dhe zhvlerësimin e asaj që kanë vendosur dhe ndër-tuar.”<sup>[38]</sup>

2. Filozofia islame, ky emërtim është më i shëmtuar se i pari.<sup>[39]</sup>

Hoxha i Islamit Ibën Tejmije thotë: "Më pas, kur u përkthyen librat e grekëve në arabisht, në qindëshen e dytë të hixhretit, para dhe pas kësaj, i morën ato pasuesit e kelamit dhe i futën në çështje të besimit dhe shumë prej njerëzve devijuan dhe u ndanë në grupe. Disa e pranorin atë, disa të tjerë e admironin shumë, ndërsa të tjerët e kundërshtonin me atë që kishin ardhur Pejgamberët, me libër dhe urtësi. Si shkak i përkthimit të tyre u shkaktuan çrregullime e trazira të shumta duke iu bashkëngjitur kësaj edhe largimi i njerëzve nga mësimet e Pejgamberëve, të cilët kishin ardhur me libra e urtësi.”<sup>[40]</sup>

Ibën Haxher el Askalanij, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Ata që erdhën pas tri gjeneratave të arta u futën dhe u zgjeruan në shumë çështje në të cilat i kundërshtuan imamët e tabiinëve dhe pasuesit e tyre, nuk ishin të kënaqur me ta derisa i përzier çështjet e fesë me filozofinë greke dhe fjalën e filozofëve e bënë bazë tek e cila ktheheshin kur binin në kundërshtim me citatat e fesë, duke i komentuar dhe shtrembëruar ato sikur të ishin të detyruar. Ata nuk u mjaftuan vetëm me kaq, derisa shpreheshin se ajo që thoshin ishte dituria më e vlefshme dhe më parimorja që duhej kërkuar dhe se kush nuk shkonte sipas asaj që ata kishin thënë, ishte analfabet dhe injorant. Dije se ai që i përmbahet rrugës së paraardhësve dhe largohet nga ajo që kundër-

shton ata, ai është me të vërtetë më fatlumi.”<sup>[41]</sup>

*“El-Mukaddimeh er-Reshideh”  
të dr. Muhamed Alu Nasër  
Përshtati: Fidan Xhelili*

[37] Po aty.

[38] Kam përmendur disa fjali të tyre në librin tim "Ediletu el vahjejn fi sherhi akidet err-Rrazijejn" (faqe 442-445).

[39] Megjithëkëtë, ky emër përhapet nëpër universitete e fakultete botërore, la havle ve la kuvete il-la bilah!

[40] "Bejan telbis el xhehmije" (1\323).

[41] "Fet'h el barij" (13\267).

# ARGUMENTET E TË KRISHTERËVE PËR TRINITETIN

Për trinitetin nuk ka prej të krishterëve fakte të cilat meritojnë të quhen argumente. Për të gjitha ato që ata kanë përmendur faktohet se kanë trilluar fjalë duke pretenduar se ato janë argumente. Nga thëniet e tyre ne do të veçojmë:

1. Allahu i Plotfuqishëm e ka përmendur emrin e Tij në gjuhën hebraike, Elohim, që aludon në shumës dhe e ka përdorur në shumës gjatë komunikimit për Vetën e Tij, ashtu siç tregohet tek Zanafilla(1), ku thuhet: "Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun..."(2)

2. Teksti i formulës së pagëzimit, që është: "Në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë", që është transmetuar në Ungjillin e Mateut 28/19.

3. Gjendja në të cilën u pagëzua Mesihu, ashtu siç transmetohet tek Mateu 3/16-17, ku thuhet: "Dhe Jezusi, sapo u pagëzua, doli nga uji; dhe ja, qiejt iu hapën, dhe ai pa Frymën e Perëndisë duke zbritur si një pëlumb e duke ardhur mbi të; dhe ja një zë nga qielli që tha: "Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur."(3)

Me këto argumente, që janë më të dobëta se rrjeta e merimangës, të krishterët pretendojnë se Allahu është tre dhe këta të tre janë një, ndërsa në anën tjetër i lënë të gjitha shkrimet e Dhiatës së Vjetër, të cilat e theksojnë tekstualisht njëshmërinë e Allahut dhe njësimin e Tij, se Qenia e Tij është një, në njëshmërinë e cilësive të Tij dhe në adhurim. Ata lënë mënjanë edhe të gjitha tekstet e transmetuara

në Dhiatën e Re, të cilat e faktojnë këtë gjë. Më poshtë do të tregojmë edhe disa prej tyre.

## *Kotësia dhe kundërshtimi i argumenteve të trinitetit*

Argumentet e lartpërmendura të të krishterëve janë aq të dobëta, saqë çdo ai mençur i kundërshton ato. Megjithatë, është e domosdoshme t'i kritikojmë ngase faktet e tyre mbi argumentimin e trinitetit kanë një pozitë madhështore në shpirtat e tyre.

## *Argumenti i parë*

Pretendimi i tyre se Elohim është në shumës është i kotë dhe bie poshtë nga tekstet e Tevratit, që theksojnë se Allahu është një, i vetëm.

Gjithashtu çifutët, të cilëve u është drejtuar ky tekst, nuk e kanë kuptuar kështu dhe as nuk kanë vepruar sipas kësaj metode, siç vepruan të krishterët, por çifutët, të thirrur në adhurimin e Zotit të vetëm, e kanë konsideruar shirk të madh (idhujtari) këtë gjë dhe kanë thënë se kush ka atë bindje, e meriton ekzekutimin.

Po ashtu, emri Elohim, ashtu siç e përmendin studiuesit, i cituar në disa prej thënieve nga të cilat përbëhet Tevrati bashkëkohor, në disa tekste të tjera në të njëjtën ngjarje përmendet me emrin Jehova.(4)

Ajo që është përmendur tek Zanafilla, ku

thuhet: "Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun...", nuk do të thotë se janë shumë (perëndi), sepse kjo është theksuar në formën e të shprehurit që tregon madhështi. Është më parësore që Allahu i Plotfuqishëm të shprehet me madhërim dhe famë, ndërkohë që janë transmetuar me qindra thënie në Dhiatën e Vjetër me nocione në numrin njëjës. Si t'i lëmë qindra thënie për shkak të kësaj thënieje të vetme dhe atyre të ngjashme me të?!

### *Argumenti i dytë*

Formula e pagëzimit: Në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Këta janë tre dhe jo një dhe kjo nuk do të thotë se kërkohet që të besohet në këta të tre, të cilët janë Allahu i Madhëruar, i Dërguari i Tij, Mesihu alejhi salam dhe engjëlli Xhibril alejhi salam. E gjithë kjo u takon atyre, nëse transmetuesi me këtë shprehje thotë të vërtetën. Më pas do të sjellim sqarime në lidhje me këtë shprehje gjatë diskutimit në lidhje me Shpirtin e Shenjtë.(5)

### *Argumenti i tretë*

Edhe sikur të saktësohej transmetimi në lidhje me argumentin e tretë, kjo formulë argumenton praninë e trefishtë, pasi kemi: Mesihun, i cili u pagëzua, Shpirtin e Shenjtë, i cili zbriti në figurën e pëllumbit, dhe thënësin nga qielli: "Ky është biri im i dashur".

Si janë pra këta të tre në një? Kjo është ajo që të krishterët nuk mund ta vërtetojnë as sipas transmetimit e as me logjikë.

### *Argumentet nga Dhiata e Vjetër dhe ungjijtë mbi vërtetimin e njëshmërisë dhe kotësinë e trinitetit*

**T**evhidi (njësimi i Allahut) është feja e të gjithë Pejgamberëve dhe këtë nuk e kundërshton askush përveç të kr-

ishterëve, të cilët ia atribuon këtë Mesihut alejhi salam, se kinse ai ka ardhur me trinitetin. Në anën tjetër, tevhidi është tema më e sqaruar në Tevrat dhe në gjithë librat që janë së bashku me të. I gjithë libri ngrihet mbi tevhidin dhe e lufton shirkun (politeizmin) dhe idhujtarinë në të gjitha format e saj.

Prej argumenteve të njëshmërisë veçojmë atë që është transmetuar te Ligji i Përtërirë: "Të tëra këto të janë treguar, në mënyrë që të pranosh se Zoti është Perëndi dhe që nuk ka asnjë tjetër veç Tij."(6)

I ngjashëm më të është edhe verseti: "Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm."(7)

Tek Ungjilli i Mateut thuhet: "Atëherë Jezusi i tha: "Shporru, Satan, sepse është shkruar: Adhuro Zotin, Perëndinë tënd, dhe shërbeji vetëm Atij."(8)

I ngjashëm me këtë është dhe verseti tek Ungjilli i Lukës 4-8.

Tek Ungjilli i Markut shkruan(9): "Atëherë një nga skribët që e kishte dëgjuar diskutimin e tyre, duke kuptuar se ai u ishte përgjigjur mirë, iu afrua dhe e pyeti: "Cili është i pari i të gjithë urdhërimeve?" Dhe Jezusi u përgjigj: "Urdhërimi i parë i të gjithëve është: "Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot..." Atëherë skribi i tha: "Mirë, Mësues. The, sipas së vërtetës, se ka vetëm një Perëndi dhe s'ka asnjë tjetër përveç Tij."(10)

Kjo është, pra, porosia e Mesihut, i cili e sqaroi dhe tha se kjo është porosia e parë dhe më madhështorja. E, sikur të bënte thirrje për trinitet, duhet të kishte përmendur ideologjinë e trinitetit në këtë rast. Atëherë, si ka mundësi që Mesihu ta transmetonte fenë nga Allahu i Lartmadhëruar e të mos e sqaronte atë që ishte gjëja më e rëndësishme e asaj me të cilën ishte i obliguar?!

Tek Ungjilli sipas Gjonit thuhet: "Dhe kjo është jeta e përvetshme, të të njohin Ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që Ti ke dërguar." (11)

Këta shkrues kanë thënë të vërtetën për Allahun dhe kjo është fjala se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, të vetmit, dhe Isai - Mesihu, është i Dërguari i Tij. Atëherë, shihni sa lart qëndron kjo fjalë rrezatuese dhe shumë e qartë në krahasim me thirrjen për trinitetin e errësuar, të cilin e shpikën të humburit në mesin e të krishterëve, të cilët e tepruan në fenë e tyre dhe i thanë këto fjalë për Allahun duke mos pasur fare të drejtë!

Allahu i Plotfuqishëm thotë: "O ithtarë të librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesihu Isa, bir i Merjemes, ishte vetëm i Dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besoni, pra, Allahun dhe të Dërguarin e Tij e mos thoni "tre" (trini). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj që Ai të ketë fëmijë. Ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur." (12)

Marrë nga libri Dirasatun fil Edjan- Jehudijeh ven Nasranijeh, faqe 277-281.

Nga: Prof. Dr. Su'ud bin AbdulAziz El Halef

*Përshtati: Adem Avdiu*

---

1. Citatet biblike janë marrë nga Bibla – Diodati i Ri, përkthim 1991-94. (sh.p).

2. Shiko Bibla – Dhiata e Vjetër, Zanafilla 1/26.

3. Shikoni Hakaiku Esasijetu fil imanil Mesihij, faqe 61.

4. Shiko për sqarimin e teksteve Kitabul Kur'anil Kerim vet Tevrat vel Inxhil vel Ilm, faqe 23.

5. Autori sqaron me argumente biblike se Shpirti i Shenjtë i thuhet engjëllit Xhibril, siç sqarohet rasti në Bibël, kur ky engjëll ka shkuar te Merjemja. Shiko për këtë Ungjilli sipas Markut 1-18, Ungjilli sipas Lukës 1-26 deri te verseti 38 (sh.p).

6. Bibla, Dhiata e Vjetër- Ligji i Përtërirë: 4-35.

7. Bibla, Dhiata e Vjetër- Ligji i Përtërirë: 6-4.

8. Bibla, Dhiata e Re- Ungjilli sipas Mateut: 4-10.

9. Këto versete tek Ungjilli i Markut janë të shënuara nën titullin Urdhërimi i madh, çka argumenton dhe tregon rëndësinë e njëshmërisë dhe me të shprehet kundërshtimi i skajshëm i trinitetit (sh.p).

10. Bibla, Dhiata e Re- Ungjilli sipas Markut: 12-28 deri në 32.

11. Bibla, Dhiata e Re- Ungjilli sipas Gjonit: 17-3.

12. Kuran, sure Nisa: 171.

# EBU BEKËR ES-SIDDIKU

**A**i është (Atik) Abdullah bin Uthman bin Amir bin Amru bin Kab bin Sad bin Tejm bin Murrah. Takohet me Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem te gjyshi i gjashtë (Murrah). Lindi në Mekë dy vjet e disa muaj pas lindjes së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe u rrit atje.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e cilësoi atë me emrin “i sinqerti” pas ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit, kur Ebu Bekri ia vërtetoi fjalën Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në një kohë kur të tjerët e përgëneshtruan. “Kur ndodhi Israja (udhëtimi i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nga Meka për në xhaminë Aksa), njerëzit filluan të flasin rreth saj dhe dezertuan nga feja disa prej atyre që kishin besuar më parë. Njerëzit shkuan tek Ebu Bekri dhe i thanë: “Çfarë thua për shokun tënd, i cili pretendon se ka udhëtuar natën për në xhaminë Aksa?” Tha: “A e ka thënë ai këtë?” Thanë: “Po.” Ebu Bekri tha: “Në qoftë se ai e ka thënë këtë, ka thënë të vërtetën.” I thanë: “A po vërteton se ai ka udhëtuar natën deri në xhaminë Aksa dhe është kthyer para mëngjesit?” Tha: “Po. Unë vërtetoj diçka më të madhe se kjo, vërtetoj shpalljen që i vjen prej qiellit paradite apo pasdite.” Që nga kjo ndodhi u quajt me emrin “i Sinqerti”.<sup>[1]</sup>

## Pranimi i Islamit dhe disa fragmente nga jeta e tij

Ebu Bekri ishte ndër më të shpejtët që iu

përgjigjën thirrjes së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, bile është i pari prej burrave që pranoi Islamit. Transmetohet nga Hemami, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Amarin duke thënë: “E kam parë Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në kohën kur nuk kishte muslimanë të tjerë përveç pesë sklleverve, dy grave dhe Ebu Bekrit.”<sup>[2]</sup> Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka lajmëruar se Ebu Bekri ishte ai që e vërtetoi kur të tjerët e përgëneshtruan, siç thotë në hadithin që e transmeton Buhariu: “Me të vërtetë, Allahu më ka dërguar te ju dhe më thatë gënjen, ndërsa Ebu Bekri tha: “Të vërtetën thua.” Ai është që më ndihmoi me veten dhe pasurinë e tij. Pra, apo e lini të qetë shokun tim? Pra, apo e lini të qetë shokun tim?”<sup>[3]</sup>

Ishte ai që e shoqëroi Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem gjatë gjithë jetës së tij, e përkrahu gjatë thirrjes së tij dhe ishte shoku i emigrimit të tij. Për t’i shpëtuar ndjekjes së kurejshëve në udhëtimin e emigrimit, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem bashkë me Ebu Bekrin hynë në një shpellë. Pas ca kohësh erdhën kurejshët te dera e shpellës dhe u ndalën aty, por nuk panë gjë sepse Allahu i madhërisëm e kishte marrë përsipër mbrojtjen e Pejgamberit të Tij dhe i bëri që të largohen. Pasi ikën, Ebu Bekri tha: Nëse ata do të shihnin poshtë, do të shihnin këmbët tona!” Tha: “O Ebu Bekër, çfarë mendon ti për dy persona, që Allahu është i treti i

[1] Transmeton Hakimi në Mustedrek 3/62 dhe Albani në Silsiletu es-sahiha, nr. 306.

[2] Transmeton Buhariu, nr. 3660.

[3] Transmeton Buhariu, nr. 3661.

tyre?”<sup>[4]</sup> Atëherë, Allahu i madhërishëm zbriti ajetin kuranor: **“Nëse ju nuk e ndihmoni Muhamedin, Allahu do e ndihmojë atë, ashtu siç e ndihmoi ditën kur e dëbuan mohuesit, kur ai ishte vetë i dyti në shpellë dhe ai i thoshte shokut të tij mos u mërzit, vërtet Allahu është me ne...”** Tevbe: 40

Ebu Bekri ishte i pranishëm në të gjitha ngjarjet përkrah Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Merrej me tregti, shiste rroba dhe pasuria e tij, kur pranoi Islamit, kishte arritur në 40.000 dërhëmë, të cilët i shpenzoi në dobi të thirrjes islame, për lirim të robërve, për sadaka për të varfrit, madje edhe Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e konsideronte pasurinë e Ebu Bekrit njësoj si pasurinë e tij. Për të treguar rolin e madh që luajti pasuria e Ebu Bekrit, le të shohim hadithin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë: “Nuk më ka bërë kurrë dobi një pasuri siç më ka bërë dobi pasuria e Ebu Bekrit.”<sup>[5]</sup> Kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u sëmur, urdhëroi që të mbylleshin dyert e sahabëve që ishin rreth e rrotull xhamisë, përveç derës së Ebu Bekrit. E urdhëroi Ebu Bekrin që të falej me njerëzit gjatë sëmundjes së tij, e përgëzoi atë me xhenet dhe u martua me vajzën e tij, Aishen, Allahu qoftë i kënaqur me të.

### **Cilësitë dhe vlerat e tij**

Cilësitë për të cilat do flasim mund t'i ndajmë në dy lloje: tipare fizike dhe virtyte morale.

1) Tiparet fizike i ka përshkruar vajza e tij, Aishja, e cila thotë: “Ishte i bardhë, i dobët, me pak qime në fytyrë, me mish të paktë në fytyrë, me sy të futur pak brenda, me ballë të dalë pak përpara.”<sup>[6]</sup>

2) Virtytet morale: Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, ishte i mëshirshëm, me zemër të butë, shumë i turpshëm, ruhej shumë nga të ndaluarat, bënte shumë dua, ishte bujar, fisnik dhe ruante nderin e tij. Ishte i pasur si në aspektin e pasurisë materiale edhe të asaj morale. Nuk ka adhuruar kurrë idhujt.

Gjithë Ehlul Suneti janë të një mendimi se njeriu më i mirë pas Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është Ebu Bekri, pastaj Umeri, pastaj Uthmani, pastaj Aliu. Ishte gjithashtu i urtë dhe i mençur. Urtësia dhe forca e vetëpërmbytjes së tij u shfaq në përballimin e fatkeqësisë së këtij umeti, vdekjes së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, moment në të cilin u shfaq personaliteti i tij i lartë dhe zgjuarsia politike në mbledhjen e Sekifes. Ebu Bekri nuk e donte këtë dynja dhe ishte shumë modest. Kjo modesti duket qartë kur iu dorëzua halifati dhe mbajti hytben e tij të mirënjohur. Gjithashtu ishte ndër më të dijsmit për Kur'anin dhe Sunnetin, kishte njohje të gjerë dhe kuptim të thellë të çështjeve të shariatit dhe të ligjeve të tij si dhe konsultohej gjithmonë me sahabët e tjerë.

### **Marrja e halifatit dhe besatimi i sahabëve**

Pasi Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem vdiq, ensarët u mbledhën në kopshtin e fisit Beni Sad (Sekife), me qëllim që të zgjidhnin halifin nga mesi i tyre. Muhaxhirët e morën vesh lajmin dhe një grup prej tyre shkuan atje. Mes tyre ishte Ebu Bekri, Umeri, Ebu Ubejdeh, etj. Foli Ebu Bekri dhe pasi tregoi vlerën dhe mirësinë e ensarëve tha: “Jam i kënaqur që të zgjidhni njërin prej këtyre dy burrave, jepjani besën cilit të doni dhe mori dorën e Umerit dhe të Ebu Ubejdes.” Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: “O ju en-

[4] Transmeton Buhariu, nr. 3653, Muslimi 4/1854.

[5] Transmeton Ahmedi në Fedailus-Sahabeh 1/65, Ibën Maxheh, etj.

[6] Marrë nga libri el Hulefa er-Rashidun, fq. 15, Eminul Kudah

sarë, a mos vallë harruat që Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e urdhëroi Ebu Bekrin t'u printe njerëzve në namaz? Pra, kujt i pëlqen të dalë para Ebu Bekrit?" En-sarët thanë: "I kërkojmë Allahut të na ruajë nga kjo!"<sup>[7]</sup> Dhe ai vazhdoi t'u kujtonte njerëzve mirësitë e Ebu Bekrit, derisa kërko-i prej tij që t'i zgjaste dorën dhe ia dha besën. Më pas ia dhanë besën muhaxhirët, pastaj edhe ensarët, duke qenë të bindur për përparësinë që kishte Ebu Bekri për t'u bërë halife. Atyre u mjaftuan fjalët e Umerit për këtë. Ditën e dytë, Ebu Bekri u ngjiti në minber dhe të gjithë njerëzit ia dhanë besën dhe e pranuan për halife. E gjithë kjo ndodhi sipas hadithit të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, të cilin e transmeton Aishja, e cila thotë: "Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në sëmundjen e tij tha: "Ma thërrit babanë tënd, Ebu Bekrin, dhe vëllanë tënd, që të shkruajë një letër, sepse unë kam frikë se mund të shpresojë dikush apo të thotë ndonjëri mua më takon. Mirëpo, Allahu i madhërishëm dhe besimtarët refuzojnë (nuk pranojnë) dikë tjetër veç Ebu Bekrit."<sup>[8]</sup>

### Disa ajete dhe hadithe rreth vlerës së Ebu Bekrit

Allahu i madhërishëm thotë: "**Vetë i dyti kur ata të dy ishin në shpellë.**" Tevbeh: 40  
**"Ai që solli të vërtetën dhe ai që e vërtetoi atë, të tillët janë të devotshmit."** Zumer: 33  
**"Ndërsa ai që është i devotshëm do të jetë larg prej tij (zjarrit), ai që jep pasurinë e vet dhe pastrohet, e jo për ta shpërblyer ndokënd që i ka bërë mirë më parë, por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të Lartit. Për Zotin, ai do ta gëzojë atë kënaqësi!"** Lejl:

[7] Transmeton Ahmedi në "Musnedin" e tij, 2/133.

[8] Transmeton Muslimi, 4/1857.

[9] Marrë nga libri Mearixhul Kabul 3/1327, Hafidh el Hakemij.

[10] Marrë nga libri Mearixhul Kabul 3/1336.

[11] Transmeton Ibën Ebi Hatimi në Tefsirin e tij me nr. 6537, Ahmedi në Fedailu es-sahabeh, nr. 613. Etheri është autentik.

[12] Transmeton Buhariu, nr. 3659, dhe Muslimi 4/1856.

[13] Transmeton Buhariu, nr. 3656.

17-21

Shumë komentues të Kur'anit thonë se këto ajete kanë zbritur për Ebu Bekrin ose kanë për qëllim atë.<sup>[9]</sup> Allahu ka thënë: "**O ju që besuat! Nëse ndonjëri prej jush braktis besimin e tij, dijeni se Allahu do sjellë njerëz të tjerë të cilët Ai i do dhe ata e duan Atë. Janë të përlurur me besimtarët dhe të ashpër me mohuesit...**" Maide: 54

Katadeja ka thënë: "Shpesh bisedonim mes vete dhe thoshim që ky ajet ka zbritur në lidhje me Ebu Bekrin dhe shokët e tij.<sup>[10]</sup> Ndërsa Hasan Basriu ka thënë: "Vallahi, këtu ka për qëllim Ebu Bekrin dhe shokët e tij!"<sup>[11]</sup>

Nga hadithet kemi:

1- Xhubejr bin Mutimi ka thënë: "Erdhi një grua te Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem për t'i kërkuar diçka. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i tha që të kthehej pas një viti. Ajo tha: "Po në qoftë se vij dhe nuk të gjej?" (Kishte për qëllim vdekjen e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) Tha: "Në qoftë se nuk më gjen mua, shko tek Ebu Bekri."<sup>[12]</sup>

2- Ebu Seidi ka thënë: "Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Allahu më ka zgjedhur të dashur të ngushtë (halil) ashtu siç kishte edhe Ibrahimin. Nëse do të kisha marrë dikë (nga njerëzit) për të dashur të ngushtë (halil), do të kisha zgjedhur Ebu Bekrin, mirëpo mes nesh ka vëllazëri në Islam dhe dashuri për hir të Tij. Të mbyllen të gjitha dyert rreth xhamisë, përveç derës së Ebu Bekrit!"<sup>[13]</sup>

3- Nga Amër ibën el-Asi transmetohet se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e dërgoi në krye të ushtrisë së betejës së zinxhirëve.

Ndër të tjera Amri thotë: “Erdha te Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe e pyeta: “Kush është njeriu më i dashur për ty?” Tha: “Aishja.” Thashë: “Po prej burrave?” Tha: “Babai i saj.” Thashë: “Po pastaj?” Tha: “Pastaj Umeri.”<sup>[14]</sup>

4- Nga Enes ibën Maliku transmetohet se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u ngjiti në malin e Uhudit së bashku me Ebu Bekrin, Umerin dhe Uthmanin, kur papritmas u drodh, u trondit Uhudi. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: “Ndalo (qëndro) o Uhud, sepse ke mbi vete një Pejgamber, një të sinqertë dhe dy dëshmorë.”<sup>[15]</sup>

5- Ebu Musa ka thënë: “Vendosa një ditë që të jem portier i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Ndërkohë erdhi Ebu Bekri, trokiti në derë. Thashë: “Kush është?” Tha: “Jam Ebu Bekri.” Thashë: “Qëndro aty ku je.” Shkova dhe pyeta Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “O i Dërguari i Allahut, ka ardhur Ebu Bekri dhe kërkon leje.” tha: “Fute brenda dhe përgëzoje me xhenet.”<sup>[16]</sup>

6- Nga Ebu Xhuhejfe transmetohet se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Ebu Bekri dhe Omeri janë zotërinjtë e burrave të banorëve të xhenetit, që prej të parëve deri tek të fundit, përveç Pejgamberëve dhe të Dërguarve.”<sup>[17]</sup>

7- Hudhejfe ka thënë: “Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Merrni shembull pas meje këta të dy”, dhe bëri me shenjë nga Ebu Bekri dhe Omeri.”<sup>[18]</sup>

8- Ebu Hurejra ka thënë: “Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Kush prej jush është sot agjërueshëm?” Ebu Bekri tha: “Unë.” Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-

lem tha: “Kush prej jush ka përcjellë sot një xhenaze?” Ebu Bekri tha: “Unë.” Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: “Kush ka ushqyer sot një të varfër?” Ebu Bekri tha: “Unë.” Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: “Kush ka vizituar një të sëmurë?” Ebu Bekri tha: “Unë.” Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: “Nuk ka person që tek ai bashkohen këto cilësi, veçse hyn në xhenet.”<sup>[19]</sup>

9- Nga Aishja transmetohet se Ebu Bekri hyri te Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe ai i tha: “Ti je rob i Allahut xhele shanuhu e ka liruar prej zjarrit.” Që nga ajo ditë, Ebu Bekri u quajt Atik (i liruar nga zjarri).<sup>[20]</sup>

10- Enesi, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Më i mëshirshmi i popullit tim me këtë umet është Ebu Bekri, më i rrepti në ligjet e Allahut është Umeri, njeriu më i turpshëm është Uthmani, ai që lexon më së miri librin e Allahut është Ubej ibën Kabi, ai që e di më mirë ndarjen e pasurisë është Zejd ibën Thabiti, më i dituri rreth halallit dhe haramit është Muadh ibën Xhebeli, çdo popull ka besnikun e tij dhe besniku i këtij umeti është Ebu Ubejdeh ibën Xherrahu.”<sup>[21]</sup>

11- Umer ibën Hatabi ka thënë: “Sikur të peshohej besimi i Ebu Bekrit me besimin e njerëzve, do të peshonte më rëndë besimi i Ebu Bekrit.”<sup>[22]</sup>

12- Abdullah bin Selemeh ka thënë: “E kam dëgjuar Aliun, Allahu qoftë i kënaqur me të, duke thënë: “Njeriu më i mirë pas Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është Ebu Bekri dhe njeriu më i mirë pas Ebu Bekrit

[14] Transmeton Buhariu, nr. 3662, dhe Muslimi, nr. 2384.

[15] Transmeton Buhariu, nr. 3675.

[16] Transmeton Buhariu, nr. 3674, dhe Muslimi, nr. 2403.

[17] Transmeton Ahmedi në Fadaïlu es-Sahabeh 1/487 dhe nr. 609, Ibën Maxheh.

[18] Transmeton Ahmedi 5/382, Ibën Maxheh, nr. 97, Tirmidhiu, nr. 3662. dhe hadithi është saktësuar nga Albani.

[19] Transmeton Muslimi, nr. 1028.

[20] Transmeton Tirmidhiu me nr. 3679. Hadithi është saktësuar nga Albani.

[21] Transmeton Ahmedi në Fadaïlu es-Sahabeh 1/544 dhe nr. 716, Tirmidhiu, nr. 3790. Hadithi është saktësuar nga Albani.

[22] Transmeton Ahmedi në Fadaïlu es-Sahabeh 1/512 dhe nr. 653, Bejhakiu.

[23] Transmeton Buhariu, nr. 367.

është Umeri.”<sup>[23]</sup>

13- Ibën Umeri ka thënë: “Në kohën kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte gjallë, thoshim: “Njeriu më i mirë i këtij umeti pas Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është Ebu Bekri, pastaj Umeri, pastaj Uthmani.”<sup>[24]</sup>

14- Ebu Bekreh thotë se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem një ditë tha: “A ka parë ndonjëri prej jush ëndërr?” Thashë: “Po, unë kam parë sikur zbriti një peshore nga qielli, ku u peshove ti nga njëra anë dhe Ebu Bekri nga ana tjetër dhe ti peshove më rëndë. Më pas u peshua Ebu Bekri nga njëra anë dhe Umeri nga ana tjetër dhe rëndoi më shumë Ebu Bekri.”<sup>[25]</sup>

### Drejtimi qeverisës që ndoqi Ebu Bekri

Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, e bëri të qartë mënyrën e drejtimit të shtetit islam prej tij nëpërmjet hytbes së tij të shkurtër, por kuptimplotë, të cilën e mbajti në xhaminë e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Pasi e falënderoi dhe e lavdëroi Allahun e madhërishëm, tha: “O ju njerëz! Unë u caktova prijës i juaji, por nuk jam më i miri prej jush. Nëse unë eci sipas së vërtetës, më ndihmoni, por nëse gaboj, më korrigjoni. Sinqeriteti është siguri, kurse gënjeshtria është mashtrim. I dobëti në mesin tuaj është i fortë tek unë derisa t’ia largoj dobësinë e tij dhe t’i jap të drejtën që i takon inshallah, ndërsa i forti tek ju është i dobët tek unë derisa të marr prej tij atë që takon t’i merret. Nuk ka popull që e lë pas dore xhihadin në rrugë të Allahut, veçse Allahu i madhërishëm i poshtëron ata. Nëse në një popull përhapet imoraliteti, Allahu i madhërishëm i përfshin të gjithë me sprova dhe fatkeqësi. Bindmuni për sa kohë i bindem Allahut i madhërishëm dhe Pejgamberit të Tij, ndërsa kur ta kundër-

shtoj Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë mos m’u bindni. Ngrihuni të falni namazin, Zoti ju mëshiroftë!”<sup>[26]</sup>

Hytbja e Ebu Bekrit përmbante këto linja kryesore të qeverisjes së tij:

1. E barazoi veten me njerëzit e tjerë përpara ligjit.
2. Bazë themelore për forcimin e mëtejshëm të shtetit bëri bashkëpunimin në të mira dhe mbarësi.
3. I dha rëndësi sinqeritetit dhe luftoi gënjeshtren.
4. Goditi zullumqarin dhe i dha të drejtën atij që i ishte bërë padrejtësi.
5. Ngriti lart flamurin e xhihadit.
6. Tregoi nënçmimin dhe poshtërsinë e imoralitetit.
7. Urdhëroi që t’i bindeshin atij për sa kohë që zbatonte ligjet e Allahut.

### Punët që ndërmori Ebu Bekri

Ebu Bekri realizoi qëllime të mëdha, arriti fitore madhështore dhe ditët e tij ishin të mbushura me mirësi, megjithëse nuk zgjatën më shumë se dy vjet e tre muaj. Punët më të rëndësishme ishin: nxjerrja e ushtrisë së Usame bin Zejdit në betejën që kishte caktuar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem pak para vdekjes së tij, luftimi i dezertorëve, grumbullimi i Kur’anit në një mus’haf (libër) të vetëm, çlirimet e tokave të reja.

1. Ushtria e udhëhequr nga Usame bin Zejdi Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kishte përgatitur një ushtri pak para vdekjes së tij dhe kishte caktuar si komandant të saj Usame bin Zejdin. Kjo ushtri, e cila përmbante njerëzit më të mëdhenj dhe më të zgjedhur në mesin e sahabëve, do të marshonte drejt rrethinave të Shamit, por nuk arriti të dilte nga Medina për shkak të sëmundjes së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

[24] Transmeton Buhariu, nr. 3655.

[25] Transmeton Ebu Davudi, nr. 4634, Tirmidhiu, nr. 2287. Hadithi është saktësuar nga Albani.

[26] Transmeton Abdurrezaku, nr. 9756, me zinxhir të saktë dhe thelbi i këtij hadithi gjendet te Buhariu, nr. 7269.

Ushtria qëndroi në gatishmëri derisa vdiq Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe halifatit e mori Ebu Bekri. Pas vdekjes së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem shumë fise arabe dezertuan nga Islami, prandaj duke u nisur nga kjo, Usama dhe shumë prej sahabëve e panë të përshtatshme që kjo ushtri të mos nisej derisa të stabilizohej situata. Mirëpo, Ebu Bekri e refuzoi këtë gjë dhe urdhëroi për marshimin e saj duke thënë: “Nuk më takon të filloj me diçka tjetër para zbatimit të urdhrit të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.” Usama u nis me ushtrinë e tij drejt tokave të Shamit, luftoi kundër fisit Kudaah, që kishte dezertuar dhe e ashpësoi luftën ndaj tyre derisa i shpartalloi ata dhe i dëboi në periferi të Mu'tes. Pasi e kreu detyrën e vet me sukses të plotë, kjo ushtri u kthye shëndoshë e mirë brenda 40 netësh.

## 2. Dezertuesit nga Islami

Ata që dezertuan nga Islami mund t'i ndajmë në tre grupe:

- Grupi i parë: Ata që u kthyen në adhurimin e idhujve.

- Grupi i dytë: Ata që ndoqën Pejgamberët e rrejshëm.

- Grupi i tretë: Ata që vazhduan në Islam, porse refuzuan dhe mohuan dhënien e zekatit duke thënë se zekati ishte obligim për sa kohë që ishte gjallë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Grupi i tretë dërgoi një delegacion në Medinë për të dialoguar me sahabët. Shumë sahabë polemizuan me Ebu Bekrin në këtë çështje (për luftimin e kësaj kategorie). Midis këtyre sahabëve ishte Umeri, Ebu Ubejde, Salimi, robi i Ebu Hudhejfes, etj.

Megjithatë, Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, e refuzoi këtë gjë dhe këmbënguli në vendimin e tij duke thënë fjalën e tij të njohur dhe madhështore: “Vallahi, sikur ata të refuzonin dhënien e një litari që ia jep-

nin Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, do t'i luftoja për këtë!”

Umeri i tha Ebu Bekrit: “Si do t'i luftosh ata, kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Jam urdhëruar që t'i luftoj njerëzit derisa të thonë “La ilahe il lallah”. E, kush e thotë këtë, e ka të siguruar veten e tij dhe pasurinë e tij, veçse me të drejtën e Islamit, ndërsa llogaria e tij është tek Allahu.”

Ebu Bekri tha: “Vallahi, do të luftoj kundër çdokujt që ndan mes namazit dhe zekatit, sepse me të vërtetë zekati është obligimi i pasurisë. Vallahi, sikur të refuzojnë dhënien e një keci të vetëm, do t'i luftoja për të!”<sup>[27]</sup>

Mendimi i Ebu Bekrit ishte se Islami është i tërësishtëm dhe nuk mund të copëtohet duke lënë jashtë një pjesë prej tij dhe duke zbatuar një pjesë tjetër. Zekati është ligji më i rëndësishëm dhe kryesor në sistemin ekonomik islam, është kusht prej kushteve të fesë dhe dhënia e zekatit është ibadet. Mendimi i sahabëve të tjerë ishte që në këtë rast të silleshin me butësi dhe me të mirë me atë kategori. Umeri tha: “O zëvendësi i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem! Sillu urtë e butë me njerëzit!” Ebu Bekri iu përgjigj duke i thënë: “Shpresoja në ndihmën tënde, kurse ti më vjen i përulur dhe i nënshtruar?! A ishe i fortë dhe i ashpër në injorancë, por tregohesh frikacak në Islam? Është ndërprerë shpallja dhe është plotësuar feja. A mos pret që të pakësohet diçka prej fesë duke qenë unë gjallë? A nuk ka thënë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “Veçse me të drejtën e Islamit”? Dhe prej të drejtës së Islamit është falja e namazit dhe dhënia e zekatit. Vallahi, sikur të gjithë njerëzit të më lënë në baltë, unë do t'i luftoja ata me veten time!”<sup>[28]</sup>

Enes bin Maliku tha: “Sahabët nuk donin t'i luftonin ata që ndalën dhënien e zekatit sepse i konsideronin muslimanë. Atëherë Ebu Bekri mori shpatën dhe doli i vetëm. Kur e

[27] Transmeton Buhariu, nr. 7284 dhe Muslimi, nr. 20.

[28] Marrë nga libri Tarihul islamij, fq. 68, Mahmud Shakir.

panë këtë, sahabët nuk kishin zgjidhje tjetër veçse ta pasonin.”

Ibën Mes’udi ka thënë: “Nuk e pëlqyem diçka të tillë fillimisht, por më pas e lavdëruam për këtë iniciativë.”

Ebu Bekër bin Ajashi ka thënë: “E kam dëgjuar Ebu Husajnin duke thënë: “Nuk ka lindur pas Pejgamberëve njeri më i mirë se Ebu Bekri, i cili luajti rolin si të ishte një Pejgamber nga Pejgamberët atëherë kur luftoi kundër dezertorëve.”<sup>[29]</sup>

Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, u dërgoi një mesazh të përgjithshëm dezertorëve në të gjithë anët e Gadishullit Arabik dhe para se të niste ushtritë në një vend, ai dërgonte njerëz atje që t’ia lexonin atij populli këtë mesazh, që t’u jepte mundësi të ktheheshin tek e vërteta si dhe të hiqte nga vetja obligimin e komunikimit para se të fillonte lufta.<sup>[30]</sup> Si rezultat i kësaj ndodhën përleshje dhe beteja mes ushtrive muslimane dhe rebelëve dezertorë. Ushtarët muslimanë dhanë maksimumin e tyre dhe shpenzuan gjithë forcat që kishin për zhdukjen e fitnes së dezertorëve, e cila u arrit brenda një viti.

3. Tubimi i Kur’anit në një mus’haf (libër) të vetëm

Ky mendim ishte i Umerit, Allahu qoftë i kënaqur me të, siç transmeton Buhariu nga Zejd bin Thabiti, i cili ka thënë: “Më thërriti Ebu Bekri pas luftës së Jemames dhe kur shkova, gjeta Umerin aty. Ebu Bekri më tha: “Umeri erdhi tek unë dhe më tha se në luftën e Jemames u vranë shumë hafizë, lexues të Kur’anit. Kam frikë se nëse vazhdon vrasja e hafizëve në beteja të tjera, do të humbasim shumë pjesë prej Kuranit dhe e shoh të përshtatshme të urdhërosh për grumbullimin e Kur’anit... Dhe vazhdoi të më bindte derisa Allahu më hapi zemrën për ta pranuar dhe rashë dakord me mendimin e Umerit. Pastaj

e urdhëroi Zejdin që të grumbullonte Kur’anin. Ai i mblodhi të gjitha gjërat në të cilat ishte shkruar Kur’ani, si p.sh. lëkurë bagëtish, degë hurme, lëvozhgë pemësh, gurë të rrafshët si dhe nga memoria e vetë sahabëve.

4. Çlirimet e reja

Pasi u forcua pushteti i Ebu Bekrit dhe u zhduk fitneja e dezertorëve, Ebu Bekri vendosi të realizonte një qëllim madhështor: të lartësonte fjalën “La ilahe il-lallah Muhamedun Rasulullah” në vise të reja. Ishte koha e përshtatshme për përhapjen e thirrjes islame dhe për çlirimin e tokave të reja jashtë Gadishullit Arabik. Këto çlirime kishin dy fronte kryesore: të persëve dhe të bizantinëve.

*Fronti i parë, ai i persëve në lindje*

Pasi mbaroi luftën kundër dezertorëve, Halid bin Uelidi u caktua nga Ebu Bekri në krye të ushtrisë për të luftuar persët, të cilët refuzuan të futeshin në Islam. Beteja e parë që u zhvillua midis dy ushtrive ishte në Kadhimeh, ku u mundën persët, u vra komandanti i tyre dhe muslimanët morën plaçka të madhe lufte. Vazhduan fitoret e njëpasnjëshme të muslimanëve në një sërë betejash, derisa nën sundimin e muslimanëve u futën shumica e tokave në perëndim të lumit Eufrat dhe si qendër e tyre u caktua qyteti Hajrah. Në muajin Sefer të vitit 13 hixhri, Ebu Bekri e urdhëroi Halidin që të drejtohej me një pjesë të ushtrisë drejt Shamit, për t’i ardhur në ndihmë ushtrisë muslimane që po luftonte kundër bizantinëve.

*Fronti i dytë, ai i bizantinëve në veri.*

Ebu Bekri nisi një ushtri drejt rrethinave të Shamit dhe në krye të saj vendosi Halid bin Seid bin Asin. Kur hasi në forcat bizantine, ai i dërgoi një letër Ebu Bekrit, në të cilën i kërkonte ndihmë dhe mbështetje. Ebu Bekri,

[29] Këto tre ethere janë marrë nga libri Mearixhul Kabul 3/1333, Hafidh el Hakemij.

[30] Teksti i këtij mesazhi gjendet në librin el Bidajeh uen-nihajeh, fq. 320-32, i shkruar nga Ibën Kethiri.

Allahu qoftë i kënaqur me të, përgatiti menjëherë katër ushtri për t' i ardhur në ndihmë. Në krye të ushtrisë së parë caktoi Amru bin el Asin, të cilin e drejtoi për në Palestinë; në krye të ushtrisë së dytë caktoi Sherahbil bin Hasenehun, të cilin e drejtoi për në Jordani; në krye të ushtrisë së tretë caktoi Jezid bin Ebi Sufjanin, të cilin e drejtoi për në Belka; në krye të ushtrisë së katërt caktoi Ebu Ubejde bin Xherrahun, të cilin e drejtoi për në Hims (qytet në Siri). Ushtritë muslimane arritën në rrethinat e Shamit dhe në Palestinë në fillim të vitit 13 h. Në fillim pati beteja të vogla mes muslimanëve dhe bizantinëve, të cilat u pasuan nga disa beteja të mëdha. Prej tyre përmendim:

a) Beteja e Axhnadinit, viti 13 hixhri

Pas disa përleshjesh mes dy ushtrive, mbreti bizantin Herakliu përgatiti një ushtri të madhe për të luftuar muslimanët. Ushtria muslimane kërkoi ndihmë prej Ebu Bekrit, i cili urdhëroi Halid bin Velidin që të drejtohej nga Iraku për në Sham. Halid bin Velidi kapërceu shkretëtirën me një shpejtësi të paparë ndonjëherë në histori për t' i ardhur në ndihmë ushtrisë muslimane. Pasi mori komandën e ushtrisë dhe e rregulloi atë në një mënyrë të përsosur, u bashkua me Amru bin el Asin, i cili po përballej me ushtrinë e madhe bizantine në vendin e quajtur Axhnadin në Palestinë. Pasi u zhvillua një luftë e ashpër, kjo betejë mbaroi me humbjen e bizantinëve dhe fitoren e bujshme të muslimanëve.

b) Beteja e Meraxhus-Sufr, viti 13 hixhri

Kjo betejë u zhvillua në jug të Damaskut, kundër forcave bizantine që kishin ardhur nga qyteti i Himsit në veri për t' u ndeshur me muslimanët në jug. Kjo ushtri e dërguar nga Herakliu përbëhej nga ushtarët më të fortë dhe më të ashpër bizantinë dhe kishte detyrë të ndihmonte sundimtarin e Dama-

skut, qytet që mbahej i rrethuar nga muslimanët. Halid bin Velidi dhe Ebu Ubejdeh, të cilët drejtonin ushtrinë muslimane, e panë të domosdoshme t' i dilnin përpara kësaj ushtrie dhe të përballeshin me të. Ushtria bizantine numëronte më shumë se dhjetë mijë ushtarë. Kur Halid ibën Velidi e pa numrin e madh të bizantinëve, e rregulloi ushtrinë me të njëjtën mënyrë që përdori në Axhnadin. Kjo betejë ndodhi në vendin e quajtur Meraxhus-Sufr dhe përfundoi si e para, me fitoren e muslimanëve dhe vrasjen e shumicës së bizantinëve.

### **Sëmundja e Ebu Bekrit dhe vdekja e tij**

Shkaku i sëmundjes së Ebu Bekrit ishte larja e tij në një ditë të ftohtë. Atë e zuri një grip i rëndë dhe qëndroi 15 ditë i sëmurë. Ai nuk dilte fare as për namaz dhe kishte urdhëruar Umer bin el Hatabin që t' u printe njerëzve në namaz. Sahabët e vizitonin vazhdimisht në shtëpinë e tij dhe Uthmani, Allahu qoftë i kënaqur me të, ishte ai që i qëndroi te koka pa u larguar. Sëmundja erdhi duke u përkeqësuar, derisa vdiq natën e martë të datës 21 Xhumadel Ahirah të vitit 13 hixhri në moshë të njëjtë me atë të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, 63 vjeç. Kalifati i tij zgjati 2 vjet, 3 muaj e 10 ditë. La si porosi që ta lante gruaja e tij, Esmā bint Amijs, dhe u qefinos në dy ose tri copa qefini. Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, ia fali namazin e xhenazes dhe e varrosi në krah të shokut të tij, Pejgamberit alejhi selam. Ia vendosën kokën e tij paralel me supin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke qenë kështu shoku i pandarë i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem si në jetë ashtu dhe në vdekje. Zoti e mëshiroftë dhe qoftë i kënaqur prej tij!

*Përgatiti: Shuajb Rexha*

# BEKARE 21-22

Allahu i Madhërishëm në vargun 21-22 të kaptinës Bekare thotë: “O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush, ashtu që të jeni të devotshëm (të shpëtuar). Ai, i cili për ju bëri tokën shtrat (vendbanim) e qiellin kulm, e prej qiellit ju lëshoi shi me të cilin ju siguroi lloje të frutave si ushqim për ju, pra mos i përshkruani Allahut shokë, duke qenë se ju e dini (që Ai nuk ka shokë).”

*Bekare: 21-22*

**K**ëto dy ajete përmbajnë urdhrin e parë që ka dhënë Allahu i Lartësuar në mus'haf dhe ky urdhër është adhurimi i Allahut, urdhri më madhështor. Këto ajete përmbajnë edhe ndalesën e parë, ndalesën e të bërit shirk dhe që t'i përshkruhet Allahut shok. Kjo është edhe ndalesa më e rreptë. Pra, këto dy ajete e bëjnë të detyrueshëm tevhidin e adhurimit, që është adhurimi vetëm i Allahut dhe shmangia e adhurimit të dikujt tjetër përveç Tij. Kjo gjë shihet qartë në fillim të ajetit të parë: "adhurojeni Zotin tuaj" dhe në fund të ajetit të dytë: "pra mos i përshkruani Allahut shokë, duke qenë se ju e dini (që Ai nuk ka shokë)". Ky, pra, është kuptimi i fjalës "La ilahe il-lallah", sepse fjala e të Madhërishmit: "mos i përshkruani Allahut shokë" është në kuptimin e fjalës "la ilahe", nuk ka të adhuruar me të drejtë, kurse fjala e Tij: "adhurojeni Zotin tuaj", është në kuptimin "il-lallah", përveç Allahut. Me këto fjalë aprovohet tevhidi i rububijetit,<sup>[1]</sup> që nënkupton se Allahu është Krijuesi i tyre dhe i atyre para tyre, se Ai e ka bërë tokën shtrat (vendbanim) dhe qiellin kulm mbi ta, Ai e lëshon shiun dhe me të u siguron atyre nga toka furnizim. Qëllimi me aprovimin e tevhidit të rububijetit është detyrimi i jobsimtarëve me tevhidin e adhurimit. Arsyeja përse ishte dërguar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe kuptimi i saj ishte se ashtu si nuk ka Krijues dhe Furnizues tjetër përveç Allahut, edhe adhurimin nuk e meriton tjetërkush përveç Tij. Për këtë arsye shpeshherë në Kur'an përmendet tevhidi i rububijetit, të cilin ata e kishin aprovuar, në mënyrë që të obligoheshin me tevhidin që e kishin mohuar, siç është fjala e të Madhërishmit Allah: "Ai që krijoi qiejt e tokën, që për ju lëshoi shi nga qielli, e Ne me të bëmë të lulëzojnë kopshte të bukura, që për ju ka qenë e pamundshme t'i bëni të

mbijnë bimët në to; a mos ka ndonjë të adhuruar tjetër me meritë pos Allahut? Jo, por ata janë popull që shtrembërojnë (të vërtetën). A është Ai që tokën e bëri vendqëndrim e nëpër të bëri të rrjedhin lumenj dhe asaj (tokës) i bëri (male) përforcuese dhe në mes dy deteve bëri ndarje. A mos ka ndonjë të adhuruar tjetër me meritë pos Allahut? Jo, por shumica e tyre nuk e dinë. A është Ai që i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur ai e thërret, duke ia larguar të keqen e juve ju bën mbizotërues të tokës? A mos ka ndonjë të adhuruar tjetër me meritë pos Allahut? Jo, por ju shumë pak përkujtoni. Ai që ju orienton në errësirat e tokës e të detit dhe ai që pranë mëshirës së Tij (shiut), si myzhde i lëshon erërat. Vallë, a mos ka ndonjë të adhuruar tjetër me meritë pos Allahut? E lartë është madhëria e Tij nga çka ia përshkruajnë shok. Ai që e fillon krijimin (e njeriut) e pastaj e përsërit atë (e ringjall pas vdekjes) dhe Ai që ju furnizon nga qielli e toka A mos ka ndonjë të adhuruar tjetër me meritë pos Allahut? Thuaj: "Sillni argumentet tuaja, nëse jeni të sinqertë!" Nemël: 60-64 Nuk ka dyshim se përmbajtja e fillimit të ajeteve, si aprovimi i tevhidit të rububijetit prej tyre, është bërë me qëllim të përmbajtjes në fund të ajeteve, që është detyrimi me tevhidin e adhurimit, siç shihet në fjalën e Tij: "A mos ka ndonjë të adhuruar tjetër me meritë pos Allahut?" Abdullah ibën Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të, e ka pyetur të Dërguarin e Allahut: "Cili është mëkati më i madh tek Allahu?" Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i është përgjigjur: "Ti bësh shok Allahut në adhurim, kurse Ai të ka krijuar." (Transmeton Buhariu (4477) dhe Muslimi 257)

*E shkëputur nga "Min kunuzil-Kur'anil-Kerim", nga Abdul-Muhsin Abbad el-Bedër  
Përshtati: Zejd Haziri*

[1] Besimi se krijimi, furnizimi, udhëheqja e gjithësisë, caktimet janë vetëm prej Allahut të madhërishëm!

# KONTRIBUTI I SAHABËVE PËR RUAJTJEN E SUNETIT

(KUPTIMI I FJALËS SAHAB, MËNYRAT PËRMES TË CILAVE MUND TË GJYKOHET SE NJË PERSON ËSHTË SAHAB DHE POZITA E SAHABËVE NË ISLAM)

**P**ara se të flasim rreth kontributit të sahabëve për ruajtjen e Sunnetit, është e arsyeshme që të japim një pasqyrë të shkurtër të asaj se çfarë nënkuptojmë me fjalën "sahab", mënyrat përmes të cilave mund të gjykohet se një person është sahab dhe pozitën e tyre në Islam.

Dijetarët e umetit islam kanë dhënë mendime të ndryshme rreth asaj se çfarë nënkuptojmë me fjalën sahab. Disa thonë se sabab është ai person që ka qëndruar një kohë të gjatë me Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem dhe ka transmetuar prej tij. Sipas tyre, nuk janë sahabë ata që vetëm e kanë parë Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem dhe nuk kanë qëndruar me të.<sup>[1]</sup>

Ky është mendimi i dijetarëve të usulit apo i disave prej tyre. Ata e thanë këtë duke u bazuar në kuptimin gjuhësor të kësaj fjale. Imam es-Sujuti, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Një gjë e tillë është në kundërshtim me konsensusin e dijetarëve të gjuhës arabe, ngase kjo fjalë mund të përdoret pa marrë parasysh kohën se sa e ke shoqëruar dikë. Thuhet: E kam shoqëruar filanin, një vit, një muaj, një javë apo një orë."<sup>[2]</sup>

Mirëpo ai që e ka definuar më së miri një gjë të tillë është el-Hafidh ibën Haxheri, i cili thotë: "Sahabij është ai që e ka takuar Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem duke besuar në të dhe ka vdekur si musliman."<sup>[3]</sup>

## *Shpjegimi i këtij definicioni*

Sipas këtij definicioni, sahabij quhet çdo njeri që

e ka takuar Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem, pa marrë parasysh sa ka qëndruar me të, shumë apo pak, ka transmetuar prej tij apo jo, ka marrë pjesë me të në beteja apo jo.

Po në këtë definicion hyjnë edhe të gjithë ata që vetëm e kanë parë, por nuk kanë qëndruar me të fare, gjithashtu edhe ata që nuk e kanë parë për shkak të ndonjë sëmundjeje si verbimi, siç është shembulli me ibën Ummi Mektumin, Allahu qoftë i kënaqur me të, muezin i Pejgamberit sal-Allahun alejhi ve sel-lem.

I ka besuar atij

Me këtë është për qëllim ai i cili është takuar me Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem dhe i ka besuar atij, mirëpo nuk konsiderohet i tillë ai i cili është takuar me Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem dhe nuk i ka besuar atij. Gjithashtu nëse ka besuar më vonë, mirëpo nuk i është dhënë rasti të takohet me Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem gjatë jetës së tij.

Imam es-Sujuti thotë: "Prej këtij përkufizimi përjashtohet edhe ai që e ka parë Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem duke qenë jobesimtar e pastaj ka pranuar Islamin pas vdekjes së tij, sal-Allahun alejhi ve sel-lem, siç është rasti me të Dërguarin e Kajserit."<sup>[4]</sup>

## *Ka vdekur si musliman*

Ka vdekur duke qenë pjesëtar i fesë islame. Me këtë përkufizim përjashtohet ai që e ka takuar Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem duke besuar në të, por më pas ka dalë, është larguar prej

[1] Tedribu er-Ravij (2\669).

[2] Po aty, me disa shkurtime.

[3] El-Isabeh (1\7-8).

[4] Tedribu er-Rravij (2\667).

këtij besimi dhe ka vdekur si murted (i dalë prej feje), siç është rasti me Ubejdil-lah ibën Xhahshin dhe Abdullah ibën Hatalin. Mirëpo, si është çështja nëse ndonjëri prej tyre e ka takuar Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke besuar në të e më pas ka dalë prej feje, por prapë është kthyer në Islam dhe ka vdekur si musliman? Imam el-Irakij thotë: "Radhitja e tij si sahabij është çështje e diskutueshme."<sup>[5]</sup>

Ndërsa imam Ebu Hanifja dhe imam Shafiu kanë thënë se dalja nga feja është gjest që shkatërron të gjitha veprat.<sup>[6]</sup> Mirëpo, Ibën Haxheri, Allahu e mëshiroftë, mendon se ky përkufizim përfshin të gjithë ata që janë larguar prej fesë islame, mirëpo janë kthyer prapë në të dhe kanë vdekur si muslimanë, pa marrë parasysh se a janë takuar me Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ndonjëherë tjetër apo jo, duke e argumentuar një gjë të tillë se të gjithë dijetarët e hadithit janë të pajtimit se Esh'ath ibën Kajsi, Allahu qoftë i kënaqur me të, numërohet prej sahabëve dhe kanë transmetuar hadithe prej tij në librat e tyre. Ky është prej atyre që ka dalë prej feje dhe është kthyer prapë në kohën e halifatit të Ebu Bekrit.<sup>[7]</sup>

### ***Mënyrat përmes së cilave mund të konstatojmë se një person është sahabij***

Dijetarët kanë cekur disa mënyra përmes së cilave mund të gjykohet se filani është prej sahabëve.

1. Të transmetohet një gjë e tillë në mënyrë mutevatir<sup>[8]</sup> (në mënyrë masive), se filani është prej sahabëve, për shembull Ebu Bekri, Omeri dhe të gjithë ata të cilët janë përgëzuar me xhenet, e kështu me radhë.

2. Njëpërmjet asaj që është e ditur haptas dhe qarkullon në mesin e muslimanëve, se filani është sahab, mirëpo duke mos arritur gradën e lajmit "mutevatir", si Damam ibën eth-Tha'lebeh.

3. Njëpërmjet dëshmisë së ndonjërit prej sahabëve se filani është prej sahabëve, si Hamemetu ibën

ebi Hamemeh ed-Devsij, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili ka vdekur në Asbahan prej një sëmundjeje të barkut. Ka dëshmuar për të Ebu Musa el-Esh'arij, Allahu qoftë i kënaqur me të, se e ka dëgjuar Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke dëshmuar për të se ka për të vdekur si shehid.<sup>[9]</sup>

Në bazë të këtij dëgjimi dhe të kësaj dëshmie ka fituar titullin sahab dhe numërohet në radhët e tyre, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Ndërsa Ibën Haxheri thotë se një gjë e tillë mund të vërtetohet edhe përmes dëshmisë së ndonjërit prej tabiinëve, se filani është prej sahabëve, duke u bazuar në atë se pranohet dëshmia qoftë edhe prej një personi, por me kusht që të jetë i drejtë dhe besnik.<sup>[10]</sup>

4. Apo të dëshmojë për veten se është sahab, nëse është besnik dhe është e mundur një gjë e tillë. Por nëse pretendon njëqind vite pas vdekjes së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, një dëshmi e tillë nuk është e pranuar ngase Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "A po e shihni këtë natë? Nuk ka dyshim se pas njëqind vitesh nuk ka për të qenë askush (prej atyre që janë sot) mbi fytyrën e tokës."<sup>[11]</sup>

Dhe në një transmetim tjetër thotë: "Pasha Allahun, nuk ka dikush që është sot mbi sipërfaqen e tokës e të jetë gjallë pas njëqind vitesh."<sup>[12]</sup>

Më vonë u paraqitën disa njerëz gënjeshtarë, të cilët pretendonin se ishin prej sahabëve të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Njëri prej tyre ishte Reten el-Hindiu, i cili u paraqit gjashtëqind vite pas vdekjes së Pejgamberit alejhi salatu ve selam dhe pretendonte se ishte prej sahabëve të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Imam Dhehebiu, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Reten el-Hindiu, e ku e di ti se çfarë është Reten el-Hindiu? Ai është Dexhal,<sup>[13]</sup> që nuk ka dyshim në të. Është paraqit gjashtëqind vite pas vdekjes së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-

[5] Et-Takjijdu ve el-Idah (262).

[6] Shiko Tedribu er-Ravij (2\667).

[7] Shiko el-Isabeh (1\7-8) dhe Fet'hul-Bari (7\4).

[8] Mutevatir është çdo lajm që transmetohet grup pas grupi nga njerëz të cilët nuk kanë mundësi kordinimi për ndonjë gënjeshtër.

[9] Tedribu er-Ravij (2\672).

[10] El-Isabeh (1\9).

[11] Transmeton Buhariu (1\ 211: 116), Muslimi (4\1965: 217).

[12] Transmeton Muslimi (4\1965: 217).

[13] Ka për qëllim se është rrenacak e jo Dexhali për të cilin ka paralajmëruar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili do të vijë si një prej shenjave të kiametit.

lem dhe pretendon se është prej sahabëve, kurse sahabët nuk gënjejnë..."<sup>[14]</sup>

### ***Pozita e sahabëve në Islam***

Nuk ka dyshim se njerëzit para shpalljes ishin në një humbje të qartë, adhurorin idhuj të ndryshëm, saqë kishin arritur deri në atë gradë ku ndonjëri prej tyre krijonte zot prej hurmash e më vonë kur e merre uria, e hante atë. Ata bënin tavaf rreth Qabes të zhveshur, i vrisnin fëmijët e tyre prej frikës nga varfëria, ndërsa vajzat e tyre i varrosnin të gjalla. Derisa Allahu i Lartësuar dërgoi Pejgamberin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem si përgëzues dhe qortues, thirrës për në rrugën e Allahut me një dritë të qartë, e cila shndriti tokën pasi ishte errësuar, bashkoi zemrat e njerëzve pasi ishin përçarë. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmuës, lajmëtar përgëzues e qortues dhe me urdhrin e Allahut thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtar ndriçues, e besimtarëve jepu sihariq se prej Allahut ata kanë dhunti të mëdha." Ahzab: 45-47

Dhe thotë: "Përkujtoni nimetin e Allahut ndaj jush, (kur ju para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar dhe Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër..." Ali Imran: 103

Kështu, Allahu i Lartësuar me dërgimin e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i nxori njerëzit nga errësitat e kufrit në dritën e besimit, në bindje të thellë se nuk e meriton kush të adhurohet përveç Allahut të Madhëruar. Nuk ka dyshim se ky ishte një amanet dhe mision i rëndë dhe i vështirë. "Ne do të shpallim ty fjalë të rëndë (të madhe)." Muzzemmil: 5

E për ta ndihmuar një mision dhe amanet të tillë, Allahu i Madhëruar kishte zgjedhur burra: "Allahu shikoi zemrat e njerëzve dhe gjeti zemrën e Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem më të mirën, prandaj e pastroi për Vetën e Tij, duke e bërë të Dërguar të Tij. Pastaj shikoi zemrat e njerëzve pas Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe gjeti zemrat e sahabëve zemrat më të mira, duke i bërë ata ministra të tij, që luftojnë në mbrojtje të fesë së Tij. Atë që muslimanët e

shohin të mirë, ajo tek Allahu është e mirë e atë që muslimanët e shohin të keqe, ajo tek Allahu është e keqe."<sup>[15]</sup>

Pra, kishte zgjedhur burra të cilët ia kishin dhënë besën Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, se do ta ndihmonin atë në çdo mënyrë dhe kështu edhe Allahu i Lartësuar ishte i kënaqur ndaj tyre. "Vërtet Allahu që i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty edhe Ai e dinte se ç'kishin zemrat e tyre, u dhuroi qetësinë dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore (çlirimin e Hajberit)." Fet'h: 18

Ia dhanë besën Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem se do të luftojnë për Allahun me pasurinë dhe veten e tyre dhe për shkak të kësaj feje ata braktisën familjet, prindërit dhe vendin e tyre. "Po ata që besuan, migruan dhe luftuan për në rrugën e Allahut dhe ata që strehuan dhe ndihmuan janë besimtarë të vërtetë. Atyre u takon falje (e mëkateve) dhe furnizimi në mënyrë të ndryshme." Enfal: 74

Ishin shembull në besim, durim, moral dhe gjithçka të mirë që ka të bëjë me virtutet njerëzore. Kështu që ne jemi të porositur të ndjekim shëmbëlltyrën e tyre.

Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë: "Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruësve) dhe prej ensarëve (vendasve, ndihmëtarëve) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhenete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitimi i madh." Tevbe: 100

Dhe thotë: "(ajo pronë) U takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe prej pasurisë së tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë prej Allahut dhe që të ndihmojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, të tillët janë ata të sinqertët, edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lak-

[14] Shiko Mizanu el-I'tidal (2\45).

[15] Transmeton imam Ahmedi në Musnedin e tij (1\379) nga Abdull-llah ibën Mes'udi.

misë së vet, të tillët janë të shpëtuar. Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: **"Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë, Ti je i butë, mëshirues."** Hashr: 8-10.

E shumë e shumë ajete të tjera kur'anore që flasin për vlerën dhe pozitën e sahabëve në Islam. Sa u përket haditheve që flasin për rëndësinë dhe vlerën e madhe të sahabëve, janë të shumta<sup>[16]</sup> po përmendim disa për ilustrim.

Është transmetuar prej Ebi Seid el-Hudrijut dhe Ebu Hurejrës, Allahu qoftë i kënaqur me ta, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Mos i shani sahabët e mi. Pasha Allahun, që në dorën e Tij është shpirti im, edhe nëse dikush nga ju shpenzon ar sa kodra e Uhudit, nuk do të arrijë vlerën e tyre më të vogël e as gjysmën!"<sup>[17]</sup> Prej Imran ibën Husejnit dhe Abdullah ibën Mesudit, Allahu qoftë i kënaqur me ta, transmetohet se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Njerëzit më të mirë janë ata të shekullit tim, pastaj ata që vinë pas tyre e pastaj ata që vinë pas tyre."<sup>[18]</sup>

El-Bera ibën Azibi, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon se e ka dëgjuar Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke thënë: "Nuk i do ensarët vetëm se besimtari dhe nuk i urren ata dikush tjetër përveç munafikut (hipokritit). E kush i do ata, Allahu e do atë. Por kush i urren ata, Allahu ka për ta urrer atë."<sup>[19]</sup>

Hatib el-Bagdadij ka përmendur me sened të tij deri tek Ebu Zurate er-Razij, i cili ka thënë: "Nëse sheh dikë duke folur keq për ndonjërin nga sahabët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dije se ai është zindik (i dalë prej feje), ngase Allahu është i vërtetë, Pejgamberi i Tij është i vërtetë dhe nuk ka dyshim se Islami na ka arritur përmes tyre. Dëshirojnë që t'i akuzojnë

dëshmitarët tanë (sahabët) në mënyrë që ta shpallin si të kotë Kur'anin dhe Sunnetin, e ata janë vetë të akuzuar dhe janë të dalë prej feje."<sup>[20]</sup>

Hafidh ibën Haxheri, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Ehlu Suneti dhe Xhemati janë unanimesë se të gjithë sahabët janë të drejtë dhe besnikë. Nuk i kundërshton dikush tjetër pos bidatxhive (rishtarëve)..."<sup>[21]</sup>

Imam Ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Të gjithë sahabët janë të drejtë dhe besnikë tek Ehli Suneti dhe Xhemati me lëvdatën dhe garancinë që Allahu i Lartësuar ka përmendur në librin e Tij fisnik dhe është e përmendur kjo gjë në hadithet e Pejgamberit, duke i lavdëruar ata në të gjitha punët e tyre, moralin dhe tërë atë që shpenzuan prej pasurisë dhe vetes të tyre vetëm e vetëm duke shpresuar shpërblimin e madh tek Allahu i Lartësuar."<sup>[22]</sup>

Ndërsa imam Ebu Xhafer et-Tahavij el-Hanefij, Allahu e mëshiroftë, thotë: "I duam shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke mos e tepruar në dashuri për asnjërin prej tyre, duke mos u distancuar nga asnjëri prej tyre. Urrejmë këdo që i urren ata, edhe atë të cilin i përmend për jo të mirë. Ne i kujtojmë ata vetëm për mirë, dashuria për ta është fe, besim dhe mirësi, kurse urrejtja e tyre është kufër, dyfytirësi dhe mohim."<sup>[23]</sup>

Në fund, e lusim Allahun e Madhëruar që të na bëjë prej atyre të cilët i duan dhe i respektojnë shokët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe e lusim Atë që të na shpërblejë dhe bashkojë në xhenet me Pejgamberët, me besnikët, dëshmorët dhe njerëzit e mirë! Sa shokë të mirë janë ata!<sup>[24]</sup>

*Përgatiti: Bali Musli Sadiku*

[16] Dr. Su'ud el-Xhurbui, Allahu e ruajtë, mësimdhënës pranë Fakultetit të Hadithit në Universitetin Islamik të Medinës, në librin e tij voluminoz me dymbëdhjetë volume, "El-Ehadithu el-Varideh fi Fadaili es-Sahabeh", ka përmblodhur hadithet që flasin për vlerën dhe pozitën e sahabëve.

[17] Transmeton Buhariu, nr. 3273, shiko Fet'hul Bari të ibën Haxherit (7\21) dhe Muslimi (4\1967:221-222).

[18] Transmeton Buhariu, nr. 3650, Fet'hul Bari të ibën Haxherit (7\3) dhe Muslimi (4\1964-1965:214-215).

[19] Transmeton Buhariu, nr. 3783, Fet'hul Bari (7\13) dhe Muslimi (1\85:129).

[20] El-Kifajeh, fq. 97.

[21] El-Isabeh (1\10).

[22] Ihtisar Ulumu el-Hadith, fq. 181.

[23] Sherhul-Akidetut-Tahavijeh, fq. 528.

[24] Kjo ishte vetëm hyrje e asaj për të cilën do të flasim në një artikull tjetër të kësaj reviste të bereqetshme insha'Allah, me temën Kontributi i sahabëve për ruajtjen e Sunetit.

# PARATHËNIA E "SUNENIT" TË IBËN MAXHES

**A**llahu i Madhërishëm në librin e Tij fisnik e ka garantuar ruajtjen e Kur'anit dhe kjo garanci përfshin edhe ruajtjen e Sunnetit të Pejgamberit të Tij. Në ruajtjen e Sunnetit kontribuan dhe shërbyen edhe dijetarët e palodhshëm, të cilët sakrifikuan çdo gjë që posedonin.

El-Hafidh Ebul Haxhaxh El-Miz-zij, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Sa i përket Sunnetit, Allahu bëri që atë ta ruajnë dijetarë të mëdhenj, hufadhë, specialistë, njohës të hadithit. Ata e pastruan hadithin nga devijimet e ekstremistëve, nga gënjeshttrat e të kotëve dhe nga komentimet e injorantëve.

Nga kujdesi që kishin për ruajtjen e hadithit dhe nga frika se mos humbiste, dijetarët e hadithit u munduan të gjenin lloj-lloj mënyrash për ta shkruar hadithin e Resulullahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Librat më autentikë, më të qëlluar, më larg gabimeve dhe më të pranuar nga masa e gjerë, por edhe nga dijetarët, janë:

1) Koleksioni autentik i imam Muhamed ibën Ismail El Buhariut.

2) Koleksioni autentik i imam Muslim ibën Haxhaxh En-Nejsaburit.

Pas tyre vijnë:

3) Suneni i Ebu Davudit.

4) El Xhami' (Suneni) i Tirmidhiut.

5) Suneni i Nesaiut.

6) Suneni i Ibën Maxhes, edhe pse ky i fundit nuk e ka arritur shkallën e librave të përmendur më lart. Allahu i mëshiroftë të gjithë këta dijetarë!

Secili koleksion ka veçoritë e veta, p.sh. sunenet janë koleksione që përmbajnë hadithe të rregullave të praktikës, si ibadete (adhurime), muamelate (marrëdhënie), etj., duke mos përmendur kapituj të historisë, tefsirit, besimit etj.

Këta libra u përhapën ndër njerëz dhe zunë vend në të gjitha trojet islame. Nxënësit e dijes ishin të interesuar t'i posedonin ata dhe për ta u shkruan shumë libra të tjerë, disa prej të cilëve sqaronin hadithet (metnin) që përmbanin këta libra, ndërsa shumë të tjerë sqaronin zinxhirët e transmetimeve (senedin), por kishte edhe të tillë që përmbledhnin të dy aspektet.<sup>[1]</sup>

Kësaj radhe kemi zgjedhur "Sunenin" e Ibën Maxhes dhe kemi shkëputur nga ai vetëm një pjesë, parathënien e tij, duke parë rëndësinë dhe nevojën e madhe që kanë lexuesit për të pasur njohuri rreth haditheve që janë vendosur në këtë parathënie, e cila gjithsej ka 266 hadithe.

Për sa u përket kuptimeve të hadithit, do të mundohemi të përmendim fjalët e dijetarëve, ndërsa sa i përket shkallës së haditheve do të mbështetemi në thëniet e dijetarit shqiptar Muhamed Nasirudin Albani, Allahu e mëshiroftë. Në vazhdim do të flasim shkurtimeisht rreth këtij suneni.

## **Autori**

Ebu Abdilah Muhamed Ibën Jezid Ibën Maxheh el-Hafidh el-Kebir el-Huxheh el-Mufessir, autor i "Sunenit", "Tarih-historia"

[1] "Tehdhib el kemal" (1\147).

dhe "Tefsir", si dhe i shumë veprave të tjera, dijetari i Kazvinit në kohën e tij. Ka lindur në vitin 209 hixhri dhe ka vdekur në vitin 273 hixhri.<sup>[2]</sup>

### Titulli i librit

Është bërë i njohur te njerëzit me emrin "Es-sunen" duke iu atribuar autorit, pra "Suneni i Ibën Maxhes".

### Metoda e tij dhe mendimet e dijetarëve rreth saj

I pari që e vendosi "Sunenin" e Ibën Maxhes në mesin e gjashtë librave të njohur është dijetari Ebul Fadël Muhamed Ibën Tahir, autor i librit "Shurut el eim-me es-site", ndërsa të tjerët në vend të këtij suneni radhitën "Muvetain" e imam Malikut.

Librin e ka radhitur në kapituj, duke përmblodhur sunetet dhe "ahkamet", rregullat e fikhut, sikurse pesë librat e tjerë. Në të ai ka transmetuar të tre llojet e hadithit: sahihun (autentikun), hasenin (të mirin) dhe daifin (të dobëtin). Gjithashtu në të gjenden edhe disa hadithe të panjohura dhe të shpikura, mirëpo në krahasim me numrin e haditheve të librit janë të pakta. Për shkak të kësaj dukurie pozita e "Sunenit" të Ibën Maxhes është në një shkallë më të ulët sesa pesë librat e tjerë.

Profesor Muhamed Fuad Abdul Bakij thotë: "Numri i haditheve në "Sunenin" e Ibën Maxhes është gjithsej 4341. Prej tyre 3002 i kanë transmetuar autorët e pesë librave të tjerë, disa nga ato hadithe i kanë transmetuar të gjithë e disa prej tyre vetëm ndonjëri. Ndërsa hadithet e mbetura, 1339, janë hadithe shtesë ndaj pesë koleksioneve të tjera. Ato ndahen në 428 hadithe sahih (autentike), 199 hadithe hasen (të mira, të pranuar), 613 hadithe me zinxhirë të dobët dhe

99 me zinxhirë të gabuar, të panjohur dhe të rrejshëm."<sup>[3]</sup>

### Kushti i tij

Nuk transmetohet asgjë nga vetë Ibën Maxhe që të ketë thënë "kam vendosur këtë kusht apo atë", por kjo gjë dihet duke mësuar zinxhirët e haditheve të tij.

Është e ditur se pozita e "Sunenit" të Ibën Maxhes është më e ulët se e suneneve të tjera për shkak se ka transmetuar në sunenin e tij disa hadithe të njerëzve të panjohur (mexhahil), të akuzuar për gënjeshtër (muttehemin) dhe në të ka edhe disa gënjeshtarë (kedhabinë).

### Interesimi i dijetarëve për "Sunenin" e Ibën Maxhes

Dijetarët treguan interesim të madh, sikurse edhe ndaj librave të tjerë, duke e përcjellë atë brez pas brezi gojarisht, por edhe në shkrim. Ata hulumtuan edhe rreth transmetuesve të tij në mesin e transmetuesve të gjashtë librave.

Ndërsa sa i përket sqarimit të haditheve të tij, nuk kemi hasur në ndonjë dijetar që e ka bërë një gjë të tillë, përveç disa sqarimeve të shkurtra që kanë bërë imam Sindi dhe imam Sujuti, Allahu i mëshiroftë, ndërsa sqarimet e imam Mugeltait deri më tani janë dorëshkrime.

Tani ju lë me parathënien e Ibën Maxhes.

1) Kapitulli mbi pasimin e Sunnetit të Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem

1. Transmetohet nga Ebu Hurejra, se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Çfarë ju kam urdhëruar, merreni atë dhe çfarë ju kam ndaluar, përmbahuni nga ajo." (Sahih-autentik)  
Sqarim: Ky hadith është i ngjashëm me fjalën

[2] Shiko biografinë e tij në "Sijer ealam en-nubela" të imam Dhehebiut (13\277).

[3] Shiko studime të Muhamed Fuad Abdul Bakij në sunenin e ibën Maxhes, fundi i vëllimit të dytë (2\1519-1520).

e Allahut në Kur'an: "Çfarë t'ju japë Pejgamberi, atë merreni dhe çfarë t'ju ndalojë, përmbahuni..." Hashr: 7.

Shprehja: "Çfarë ju kam urdhëruar" përfshin edhe gjërat obligative edhe ato vullnetare. Shprehja "dhe çfarë ju kam ndaluar" përfshin haramet (ndalesat), por edhe të urryerat.

Ligjërimi, edhe pse u është drejtuar atyre që kanë qenë të pranishëm, i përfshin unanimisht edhe ata që s'kanë qenë të pranishëm.

2. Transmetohet nga Ebu Hurejra, se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Mos e teproni me pyetje për atë që ju kam mësuar, sepse ata që ishin para jush u shkatërruan për shkak të pyetjeve të tepërta dhe kundërshtimit të tyre ndaj të Dërguarve. Nëse ju urdhëroj me diçka, veprojeni atë sa të keni mundësi dhe nëse ju ndaloj nga diçka, përmbajuni."

Hadith autentik.

Sqarim: Shkakun e thënies së këtij hadithi e transmeton imam Muslimi nga Ebu Hurejra, që thotë: "Na ligjëroi Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe tha: "O ju njerëz, Allahu ua ka bërë haxhin obligim, atëherë bëni haxh. Një njeri i tha: "A për çdo vit, o i Dërguari i Allahut?" Pejgamberi heshti, derisa e përsëriti njeriu tri herë. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i tha: "Sikur të thosha po, do të bëhej obligim për çdo vit dhe nuk do të kishit mundësi." Pastaj tha: "Mos e teproni me pyetje për atë që ju kam mësuar ..."

Imam Darekutni e transmeton të njëjtin hadith duke thënë se pas kësaj ngjarjeje zbriti fjala e Allahut: "O ju që keni besuar, mos pyetni për gjëra që, nëse ju shfaqen, nuk ju vjen mirë..." Këtë e ka transmetuar edhe imam Taberiu nga Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Shprehja "Mos e teproni me pyetje": për gjëra që nuk kanë ndodhur, duke pasur frikë se mos bëhet obligim, siç e pyeti sahabiu për haxhin, se a është obligim për çdo vit.

Ibën Ferexh për këtë thotë: "...do të thotë mos i detajoni gjërat shumë duke kërkuar për çdo gjë sqarim, sidomos në gjërat që janë të qarta dhe kuptohen edhe pa hyrë në detaje, si p.sh. çështja e haxhit, kur i Dërguari i Allahut ka thënë se bëni haxh. Kjo kuptohet në esencë, se haxhi është vetëm një herë në jetë, pra mos pyetni për çështjet që janë të kuptueshme nga vetë teksti e pastaj t'ju vështirësohet, siç vepruan beni israilët, kur Allahu i urdhëroi të thernin një lopë. Sikur ata të thernin çfarëdo lope, do ta zbatonin fjalën e Allahut, mirëpo kur vazhduan të pyetnin për gjëra që Allahu nuk i kishte ngarkuar, kur pyetën se çfarë lope ishte ajo, çfarë ngjyre kishte etj., atëherë Allahu ua vështirësoi dhe ua kushtëzoi që të thernin një lopë me disa cilësi, e cila gjendej vetëm në një vend. E gjithë kjo për shkak të pyetjeve të panevojshme nga ana e beni israilëve.

Transmeton Bezari dhe Ibën Ebi Hatimi në Tefsirin e tij nga Ebu Hurejra, nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, se ka thënë: "Sikur benu israilët të thernin çfarëdo lope, do t'u mjaftonte atyre, mirëpo ata ia vështirësuan vetes. Atëherë, Allahu ua vështirësoi atyre." (Ibën Haxheri thotë hadith hasen-i mirë). Transmetohet edhe nga Ibën Abasi si fjalë e tij.<sup>[4]</sup>

*Vijon*

*Përgatiti: Fidan Xhelili*

[1] Marrë nga "Fet'hul Barij", Ibën Haxher El Askalanij, Allahu e mëshiroftë (13\261).

# HYRJE NË SHKENCAT E FIKHUT (II)

## Përkufizimi i Fikhut

Çfarë nënkuptojmë me fjalën fikh?

**F**ë çdo dituri, është e nevojshme qysh në fillim që të njihet thelbësisht, duke u nisur nga përkufizimi i saj gjuhësor dhe shkencor apo përkufizimi i saj etimologjik dhe terminologjik.

Kjo njohje bëhet në mënyrë që lexuesi qysh në fillim të ketë një pasqyrë të qartë para vetes, se për çfarë do të flitet në vazhdim, pasi kjo e ndihmon të jetë më i përgatitur që t'i pranojë më lehtë dhe qartë gjërat që shpjegohen në vazhdim të temës për të cilën bëhet fjalë.

Në fillim të Islamit, termi fikh ka përfshirë gjithë fenë, bile nëse është përmendur fjala fikh në gjuhën e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe të shokëve të tij, ka nënkuptuar dituritë islame në tërësi dhe nga ky term janë përjashtuar vetëm dituritë që nuk kishin lidhje me Islamin. Pra, fikhu përfshinte të gjitha dituritë që nxirreshin nga Kur'ani dhe hadithi i Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem.

Personi që kishte njohuri të plotë në çështjet

fetare në kohën e sahabëve dhe të tabi'inëve quhej fekih, ngase çdo gjë që kishte të bënte me çështjet fetare ata e quanin fikh, ashtu siç ka thënë Imam Ebu Hanifja, Allahu e mëshiroftë: "Fikhu është njohja nga ana e individit se çfarë është për të (çfarë i bën dobi në botën tjetër) dhe çfarë është kundër tij (çfarë i bën dëm në botën tjetër)."<sup>[1]</sup>

Me një fjalë, fikhu në kohën e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe të sahabëve ka përfshirë adhurimet trupore, moralin, edukatën, besimin, bile besimi është quajtur fikhu më i madh (fikhul ekber).<sup>[2]</sup>

Mirëpo më vonë, pas gjeneratës së sahabëve dhe të tabi'inëve, fjala fikh është përdorur si term i veçantë, i cili përfshin vetëm një drejtim të Islamit. Këtu kam për qëllim çështjet që kanë të bëjnë me veprat trupore të individit apo gjymtyrët e tij, siç janë: namazi, zekati, agjërimi, haxhi, etj., dhe jo edhe çështjet e besimit dhe të moralit, siç do të sqarojmë më poshtë. Thuhet se nga të parët që e kanë kufizuar kuptimin e fikhut nga domethënia tij e gjerë, siç ishte në kohën e sahabëve dhe të tabi'inëve, ishte Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë.<sup>[3]</sup>

[1] Shiko "Et-tevdiih alat-tankiih"(1/04) Ubejdullah ibën Mes'ud, i njohur me nofkën Taxhush-sheriah.

[2] Vlen të theksohet se po me të njetin titull "fikhul ekber" ekziston një libër që kinse e ka shkruar Imam Ebu Hanifeja, edhe pse dijetarët kanë mospajtim mes tyre se vërtetë këtë libër e ka shkruar Ebu Hanifeja apo jo! Sidoqë të jetë, kjo libër tashmë gjendet edhe në bibliotekat shqiptare! Lus Allahun që në numrat e ardhshëm të kësaj reviste të më lehtësojë të shkruaj një temë të veçantë në lidhje me këte libër, si dhe përkthimin dhe komentimin e tij në gjuhën shqipe, në mënyrë që lexuesi shqiptar të jetë syqel se çfarë lexon, sidomos kur këto libra kanë të bëjnë me çështjet e besimit. Poashtu, të jetë edhe si këshillë për libraritë islame dhe pronarët e tyre se çfarë po i servojnë masës së gjerë, dhe sa përgjegjësi të madhe bartin para Allahut, pasi që ata ose janë porta ku shpërndahet e vërteta ose janë porta përmes së cilës shpërndahet e kota me petkun e të vërtetës!! Allahu na mundësoft ta njohim të vërtetën dhe të punojmë sipas saj, S'ka dyshim se vetëm Ai jep sukses!

[3] Shiko "Sherh Xhem'ul Xhevami" (1/32) Nga Xhelaludin el-Mehal-li.

## Përkufizimi gjuhësor i fikhut

**F**jala fikh në gjuhën arabe do të thotë njohje e një gjëje apo kuptim i saj, ose zgjuarsia në të. Arabët thonë: “I është dhuruar personit fikh në fe”, d.m.th. i është dhuruar atij kuptimi dhe njohja e fesë.<sup>[4]</sup>

Fikhun me këtë kuptim e gjejmë edhe në ajete të Kur’anit. Musai alejhi selam në duanë e tij drejtuar Allahut, pasi e obligoi atë me librin e shenjtë, Tevratin, tha: **”Ma zgjidh nyjën e gjuhës sime! Që ta kuptojnë fjalën time!”** Taha: 27-28

Kur i Dërguari i Allahut, Shuajbi alejhi selam, e thirri popullin e tij që t’i përgjigjej thirrjes së Allahut, ata iu përgjigjën duke i thënë: “O Shuajb, ne nuk po e kuptojmë shumicën nga ajo që thua...” Hud: 91

Po ashtu, Allahu thotë: ”E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ata, në mënyrë që ata të kuptojnë?” Tevbe: 122

Edhe pse kjo ishte domethënia e fikhut në gjuhën arabe, prapëseprapë shohim që dijetarët e usuli fikhut<sup>[5]</sup> kanë rënë në mospajtim se çfarë në të vërtetë aludon në gjuhën arabe fjala fikh. Ata janë ndarë në katër mendime.

### Mendimi i parë:

**F**jala fikh do të thotë “kuptimi i qëllimit të folësit”, pavarësisht nëse qëllimi i tij është i specifikuar—i përpiktë apo është i qartë-i hapur dhe nuk thuhet e ka kuptuar përderisa nuk e ka kuptuar qëllimin e folësit. Prandaj, edhe kur i

thua dikujt “e kuptova fjalën tënde”, ke për qëllim e kuptova qëllimin tënd me atë fjalë dhe jo vetëm fjalën si fjalë. Përndryshe, disa fjalë në kuptimin e parë të tyre pa shikuar qëllimin e folësit aludojnë kuptime të kundërta me qëllimin që ka folësi, si p.sh. të pastë humbur nëna! Këtu qëllimi i folësit është nxitja e bashkëbiseduesit të tij që të dëgjojë me vëmendje atë që do t’i thuhet në vijim, edhe pse fjalët e tij për nga përmbajtja e tyre sipërfaqësore kanë kuptim tjetër, madje negativ. Të këtij mendimi janë disa dijetarë, në mesin e të cilëve edhe Rraziu dhe Ibnul Kajjimi, Allahu i mëshiroftë.<sup>[6]</sup>

### Mendimi i dytë:

**F**jala fikh do të thotë “njohja e një gjëje dhe kuptimi i saj”, pavarësisht nëse ky kuptim është i specifikuar apo i thjeshtë dhe pavarësisht në është ai qëllimi i folësit apo jo. Këtë mendim e kanë përzgjedhur disa dijetarë, në mesin e të cilëve edhe dijetari i njohur i usulit, Ebu Hamid el-Gazali, Allahu e mëshiroftë.<sup>[7]</sup>

### Mendimi i tretë:

**F**jala fikh do të thotë esenca e kuptimit dhe jo edhe njohja e saj, ngase njohja e një gjëje detyrimisht nënkupton edhe kuptimin e saj, por jo edhe e kundërta! Pra, ky mendim bën ndarje mes kuptimit dhe njohjes, ngase njohja është diçka më e veçantë sesa kuptimi, kështu që kuptimi i një gjëje quhet fikh, pavarësisht nëse ke njohuri për të apo jo. Këtë mendim e përkrah Amidiu, Ibën Kudame, Shevkani dhe shumë të tjerë, Allahu i mëshiroftë.<sup>[8]</sup>

[4] Shiko “Lisanul Arab”(13/522), “Muhtarus-Sihah” (1/517), “El Kamusul Muhit” (1/1614).

[5] Janë dijetarët e specializuar në lëminë e “usulit fikhut”, e kjo lëmi merret me argumentet e fikhut në formë të përgjithshme dhe mënyrën se si nxirren dispozitat prej tyre, duke mos u futur në hollësira dhe degëzime të fikhut.

[6] “El Mahsul” (1/93), “I’lamul Muveki’iin”(1/359).

[7] “El Mustesfa” (1/05).

[8] “El-Ihkam fi usulil-Ahkam” (1/33), “Ravdatun-nadhir”(1/53), “I’rshadul Fuhul”(1/17)

## Mendimi i katërt:

**F**ikh do të thotë kuptim i gjërave të paqarta apo i gjërave të turbullta e jo edhe i gjërave të qarta. Këtë mendim e përkrah Ebu Is'hak el-Mervezi, Allahu e mëshiroftë.<sup>[9]</sup>

## Fikhu në terminologji

**P**asi sqaruar kuptimin e fikhut sipas gjuhës arabe dhe mospajtimin e dijetarëve për të, tani do të përmendim përkufizimin e fikhut sipas terminologjisë, duke sqaruar çdo shprehje që përmban ky përkufizim dhe duke nxjerrë jashtë çdo gjë që nuk i përket atij.

Siç e përmendëm edhe në fillim, përkufizimin që njihet sot thuhet se e ka dhënë Imam Shafiu, mirëpo prapëseprapë nuk mbeti përkufizimi i vetëm, ngase dijetarët e tjerë i dhanë fikhut edhe përkufizime të tjera. Mirëpo, për dallim nga përkufizimi gjuhësor i fikhut, për të cilin ekzistojnë mospajttime të qarta, në përkufizimin terminologjik shohim se nuk ka dallime të mëdha, bile përkufizimet e tyre janë tepër të përafërta. Ajo që mund të vërehet si dallim është se disa prej tyre kanë lënë disa gjëra mangët gjatë përkufizimit të fikhut, kurse pala tjetër i ka plotësuar ato mangësi, prandaj edhe mospajtimet e tyre rreth këtij përkufizimi mbeten në fjalë, pasi në praktikë nuk ka dallim mes tyre. Por edhe nëse ka ndonjë dallim mes tyre, atëherë ai dallim mbetet jo shumë i theksuar sepse ose është dallim i rrallë, ose është i ndonjë

dobie jo të madhe.

Nisur nga ky fakt, e pashë të arsyeshme të mjaftohem me përkufizimin e Imam Shafiu, të cilin e kanë pëlqyer shumica e dijetarëve pas tij, ngase përkufizimi i tij është përmbledhës, nuk lë vend për shtesa dhe me të nuk mund të përkufizohet ndonjë drejtim tjetër islam.<sup>[10]</sup>

Përkufizimi i dhënë nga ai dhe i zgjedhur nga shumica dërrmuese e dijetarëve është: “Fikhu është njohja e dispozitave të sheriatit që lidhen me veprat e individit, të përfituara nga argumentet e hollësishme”.<sup>[11]</sup>

## Sqarimi i përkufizimit

**M**e fjalën “njohja” është për qëllim njohja e cila përmban në vetvete bindje të prerë ose bindje dominuese ndaj njohjes që vjen nga ndonjë dyshim eventual.

Përjashtohet nga kjo njohja që arrihet përmes paragjykimeve, iluzioneve apo supozimeve, të cilat nuk janë të bazuara në argumente. Me fjalët “e dispozitave të sheriatit” nënkuptojmë dispozitat e nxjerra nga argumentet e sheriatit, siç është Kur’ani, Sunneti, ixhmai dhe kijasi.<sup>[12]</sup>

Vepra e kryer nga muslimani quhet obligim (vaxhib), e ndaluar (haram), e pëlqyer, e rekomanduar (mendub-mustehab), e urreyer (mekruh) ose e lejuar (mubah). Pra, këto janë dispozitat e sheriatit mbi njeriun. Këtu përjashtohen njohuritë që përfitohen nga logjika, si p.sh. njëshi është gjysma e dyshit,

[9] “El-Med’hal ilash-sheriatu vel fikhil islamij” (fq,32).

[10] Dijetarët e Usulit kur flasin për përkufizimin e diturive apo nocioneve në sheriat, ata kushtëzojnë dy gjëra që ky përkufizim të jetë korrekt:1)Të jetë përmbledhës (Xhami’) d.m.th që përkufizimi të përmbledhë sa më shumë përmbajtjen e të përkufizuares, dhe 2)Të jetë ndalues për ndonjë lëmi tjetër (Mani’) d.m.th të mos ketë mundësi me këtë përkufizim të përkufizohet ndonjë lëmi tjetër, pra, të mos lejojë që ky përkufizim të përdoret edhe në lëmitë apo nocionet tjera.

[11] Shiko përkufizimin dhe komentin e tij –duke pas parasysh se në të gjitha këto referenca nuk është i njëjti përkufizim që kam zgjedh unë:–“el-mustesfa”(1/05), “el-mahsul”(1/92), “el-lum’u fi usulil fikh”(1/06),“el-ibhaxh fi sherhil minhaxh”(1/28), “el-bahrul muhit fi usulil fikh”(1/15),“et-temhid fi tahrilihil furui ael usul”(1/50),“nihajetus-sul sherh minhaxhul vusul”(1/18), “el-kavaid ibn leh-ham”(1/4-5),“irshadul fuhul”(1/17-18),“mudhekkeretu usulil fikh”(fq,1-2)

[12] Nëse do Allahu në numrin vijues do të flasin më gjerësisht për këto argumente -Kur’anin, Sunnetin, Ixhmain dhe Kijasin (Analogjia)-, në temën “Burimet e Sheriatit”.

apo njohuritë që përfitohen nga përvoja, si p.sh. njohja se zjarri është djegës.

Fjalët “që lidhen me veprat e individit” sqarojnë se këto dispozita të shariatit lidhen me veprat që dalin nga muslimani, qofshin ato adhurime, siç janë: pastërtia, namazi, zekati, haxhi, agjërimi etj., apo rregulla ndërnjerëzore, siç janë: martesë, divorci, shitblerjet, trashëgimia etj.

Këtu përjashtohen çështjet e besimit që janë të lidhura me zemrën e individit, siç janë: njësimi i Allahut, njohja e emrave dhe e atributëve të Tij dhe të luturit e Tij me to, frika dhe shpresa ndaj Tij etj.

Fjalët ”të përfituara nga argumentet” sqarojnë se këto dispozita të shariatit duhet të nxirren nga argumentet e tij dhe konsiderohen nga fikhu vetëm nëse rrjedhin nga ato burime. Ja, pra, fikhu islam nuk është i përpiluar nga ndonjë individ i caktuar apo nga ndonjë shtet, ashtu siç përpilohen kushtetutat e shteteve, por buron vetëm nga ligjet që vijnë nga Krijuesi i Madhërisëm.

Këtu përjashtohet dija e mukal-lidit– pasuesit të ndonjë medhhebi pa argumente-, ngase këto dispozita të shariatit ai nuk i nxjerr nga argumentet, por i mëson ashtu siç ia ka rezervuar imami i tij. Duke u nisur nga kjo, dijetarët nuk e kanë quajtur fekih atë person që ka pasuar ndonjë medhheb të caktuar, pasi fekih quhet personi i cili i nxjerr dispozitat e shariatit nga argumentet duke mos pasuar dikë tjetër.

Fjala ”e hollësishme” sqaron se dispozitat në fikh nxirren nga argumentet e hollësishme të shariatit dhe për secilën çështje kërkohet argumenti adekuat, duke mos u mjaftuar me argumentet e përgjithshme; kuptohet, nëse gjendet argumenti i veçantë. Pra, fekihi duhet të dijë përmendësh në mënyrë të hollësishme argumentet e Kur’anit dhe të Sunnetit, të cilat kanë të bëjnë me atë dispozitë

për të cilën ka formuar bindje, qoftë ajo e lejuar apo e ndaluar.

Përjashtohen nga kjo argumentet e përgjithshme (të cilat nuk tregojnë dispozitë të veçantë), ngase ato janë pikësypnim i dijetarëve të usulit. Ata (dijetarët e usulit) studiojnë llojin e argumenteve, cilësinë e tyre dhe si nxirren dispozitat prej tyre, si p.sh. urdhri që vjen nga Kur’ani apo Sunneti, a aludon për obligueshmëri apo jo, duke mos u futur në hollësi dhe detaje siç veprojnë dijetarët e fikhut.

Allahu e di më së miri!

*Vijon*

*Përgatiti: Xheladin Leka*

# KUSHTET PËR NGRITJEN E FESË

**K**y umet ka obligime të shumta e sublime, në mesin e të cilave është edhe ngritja e fesë dhe mospërçarja rreth saj: **"Ai ju përcaktoi juve për fe atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirri ata. Allahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij."** Shura: 13.

Umeti ngritjen e fesë mund ta arrijë me anë të tevhidit<sup>[1]</sup> dhe unitetit, duke u bashkuar në të<sup>[2]</sup> dhe në këtë mënyrë dallohet nga idhujtaria dhe idhujtarët. Meqenëse kjo nuk mund të bëhet vetëm se përmes zgjedhjes, mëshirës dhe udhëzimit nga ana e Allahut të Madhërishëm, Allahu i Lartësuar thotë: "Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete), përveç atij që e mëshiroi Zoti yt." Mirëpo, ky umet nuk mund ta realizojë ngritjen e fesë pa zbatuar çështjen e referimit<sup>[3]</sup> te dijetarët e vet dhe kjo gjë ka nevojë për plotësimin e disa kushteve. Më të rëndësishmet janë:

- Njohja profesionale e ligjit të Allahut dhe pasimi i metodologjisë pejgamberike, si dhe vlerësimi i denjë i përmbajtjes së shpalljes.

- Moskundërshtimi e mospërçarja, të cilat nuk mund të arrihen vetëm se duke larguar armiqësinë që muslimanët kanë mes tyre. Allahu i Lartësuar thotë: **"Po ata, [4] vetëm pasi u erdhi e vërteta, nuk u përçanë për tjetër pos nga zilia mes tyre."** Shura: 14

Pra, ashtu siç është e rëndësishme dituria në realizimin e çështjes së referimit te dijetarët, edhe mosarmiçësia dhe transparenca si dhe të qenët të drejtë janë të rëndësishme që ajo të ketë efekt dhe të plotësohet kështu zhvillimi i një ambienti me iman, ku njerëzit edukohen me gjërat elementare para atyre kulminante. Kështu arrihet bindja

tek njerëzit se edukimi i përfutur prej tyre është i shëndoshë dhe i drejtë, sepse përndryshe në damarët e tyre do të qarkullojë dobësia dhe degradimi si pasojë e dyshimit të pranishëm në zemrat e tyre, siç ka shpjeguar edhe Allahu i Madhërishëm pas fjalës së Tij: **"Po ata, vetëm pasi u erdhi e vërteta, nuk u përçanë për tjetër pos nga zilia mes tyre"**. Ai thotë: **"Dhe sikur të mos kishte paraprirë fjala e Zotit tënd (për shtyrjen e dënimit) deri në një afat të caktuar, ata do të gjykoreshin menjëherë. Edhe ata<sup>[5]</sup> që trashëguan librin më pas dyshojnë thellë në të."** Shura: 14

Pra, sigurisht që mes umetit dhe referencës së tij<sup>[6]</sup> qëndron një lidhje e fortë, mirëpo sa herë që umeti i drejtohet referencës që nuk i plotëson veçoritë e sipërpërmendura, pa dyshim që është duke e kërkuar shkatërrimin me duart e veta dhe bën krim ndaj vetvetes. Sa herë që umeti tregohet neglizhent ndaj dijetarëve të vet dhe e asgjëson vlerën e tyre me ofendime dhe llagape, ai vetëm se është larguar nga të ngriturit lart me shkallë të sigurt. Çdo meditues i mprehtë dhe vëzhgues durimtar i ligjeve të Allahut mund të aprovojë pa kurrfarë hezitimi se pozita e këtij umeti ndaj umeteve të tjera varet prej pozitës së dijetarëve të tij te ky umet. Atëherë, a thua ka ardhur koha që njerëzit ta kuptojnë këtë dhe të ndjekin hapat drejt marshimit të drejtë të natyrshmerisë, larg etheve të injorancës dhe zinxhirëve të fanatizmit partiak?! Hoxha i Islamit Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "...dhe po ashtu kush dëshiron që injorantin ta bëjë mësues të njerëzve apo myfti të tyre, kush dëshiron që të paafin frikacak ta bëjë luftëtar të njerëzve ose dëshatakun, i cili nuk kupton gjë, ta bëjë udhëheqës të njerëzve ose të kafshëve, personi me tendencë të tilla e prish rendin në botë dhe sjell kaos."<sup>[7]</sup>

*E shkëputur nga revista "el-Asale", nr. 36, viti 1422 h.*

*Përshtati: Zejd Haziri*

[1] Tevhid: të gjitha adhurimet tona, jeta dhe vdekja të bëhen vetëm për Allahun dhe për askënd tjetër.

[2] Duke u bashkuar në fenë që i është shpallur Pejgamberit tonë dhe shokëve të tij e jo në fenë e stërmëshur me risi dhe ideologji sektare, që me metodat e gabuara dhe kontradiktore me atë të Pejgamberit tonë e ka zbehur imazhin e muslimanëve.

[3] Në jetën e përditshme apo në problemet aktuale, qofshin ato politike, sociale ose ekonomike.

[4] Hebrejtë dhe të krishterët.

[5] Fisi Kurejsh në Mekë.

[6] Dijetarët e umetit.

[7] El-Hasenetu ves-Sejjietu", fq.84.

# SISTEMI FAMILJAR NË ISLAM (III)

## Qëndrimi i Islamit në lidhje me punësimin e gruas

**N**e nuk themi, siç mund të mendohet, se gruaja nuk duhet të dalë nga shtëpia për t'u ballafaquar me punën. Kurrresi, por gruaja muslimane punon dhe ka variante të shumta pune.

Thënia se Islami e ndalon gruan nga të punuarit është njollosje për Islamin dhe emrin e tij, gjithashtu edhe fjala se vendet e punës së saj janë të pakta nuk është fjalë e analizuar mirë. Gruaja muslimane është e lirë të ballafaqohet me punën e saj duke mos qenë në vende ku ka burra apo të përzihet a të vetmohet me ta.

Gruaja mund të jetë mësuese, drejtoreshë ose mund të punojë në zyrat e shkollave për femra. Ajo mund të punojë gjithashtu si doktoreshë, infermiere, zyrtare apo çdo punë që i përshtatet në spitalet e posaçme për gra si dhe punë të tjera që i përshtaten natyrës së saj.

Ndërsa për atë grua e cila del nga shtëpia e saj, me qëllim që të kërkojë

punë, e zbukuruar me zbukurimet e saj dhe e parfumuar në gjendje të urryer e duke u përdredhur sikur po reklamon veten e saj kur kalon mes burrave, qëndrimi i Islamit për të është të ngjasuarit e saj me prostitutën, ashtu siç është vërtetuar nga Tirmidhiu në hadithin e Ebu Musa el Eshariut, se i Dërguari i Allahut, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nëse gruaja parfumohet dhe kalon pranë burrave, ajo është kështu e kështu! D.m.th: lavire."<sup>[1]</sup>

Tirmidhiu thotë: "Ky është hadith i saktë."

Hadith të ngjashëm me këtë ka transmetuar edhe Ebu Davudi nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të. Ajo që duket nga shprehja "lavire" është se ajo është fjalë e Ebu Musa el Eshariut si sqarim nga ai për fjalën "kështu e kështu", e Allahu e di më së miri.

Shembulli i gruas është si shembulli i një njeriu i cili ka përgatitur një lloj ushqimi të shijshëm me mundime të shumta, pastaj e merr me vete në qosh të rrugës afër një moçali dhe ia heq mbulesën. Pastaj atij i vërsulen insektet nga çdo vend nga aroma e tij. Mizat

[1] Transmeton Ebu Davudi (4173), Tirmidhiu (2786), Nesaiu (5126) nga hadithi i Ebu Musa el Eshari. Shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, e ka konsideruar të saktë në "Sahih el Xhami" (323).

sillen rrotull enës dhe disa prej tyre bien në të, ndërsa njerëzit e vështrojnë atë ushqim me pështirosje dhe fytyra të vrenjtura. Ndërsa në mbrëmje ai ushqim bëhet darka e qenve, pasi e kanë mbuluar insektet.

Kështu është shembulli i atyre që shëtisin të zbukuruar nëpër rrugë, kështu që le ta pastrojë veten e saj muslimania dhe të ruajë nderin dhe virtytin e saj nga kjo ulje dhe të veshë mbulesën e ndrojtjes në trupin e saj, ashtu si e ka urdhëruar Zoti i saj. Kjo është më e mirë për të tek Allahu si dhe në mesin e shoqërisë.

Pas gjithë kësaj, Islami dëshiron që të ruajë familjen muslimane, sepse rregullimi i saj është rregullimi i të gjithë shoqërisë, ashtu siç është edhe prishja e saj prishje e masës së gjerë.

Islami është kujdesur me një kujdes të veçantë për këtë kuptim. Ky kujdes nuk mungon as gjatë kohës së kryerjes së disa adhurimeve, të cilat janë të përbashkëta mes burrave dhe grave, në një vend të përbashkët si namazi i xhumasë dhe i dy bajrameve. Edhe këtu Islami e ka programuar si të kryhen edhe këto grumbullime gjatë adhurimeve.

I Dërguari me udhëzimin e drejtë, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, duke i rregulluar safat (rreshtat) për namaz ka thënë: "Rreshti më i mirë për burra është ai i pari dhe më i keqi ai i fundit, ndërsa për gratë rreshti më i keqi është ai i pari."<sup>[2]</sup>

Dhe nga njohja e tij, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, për atë që ndikon gruaja e parfumuar në gjokset e burrave, ai ka urdhëruar duke thënë: "Nëse gruaja del për në xhami, të lahet nga parfumi ashtu siç lahet nga xhunubllëku."<sup>[3]</sup>

Them: Hadithi i fundit dhe ai para këtij llogariten nga shembujt më të fortë për parandalimin e së keqes, siç mund të vërehet. Allahu na mundësoftë të mirën!

## Dhënia fund jetës bashkëshortore

**T**eta bashkëshortore merr fund me njëri nga këto dy ndarje:

1. Ndarje me vdekjen e njërit prej tyre, shpejtimin apo vonimin e së cilës nuk e zotëron asnjëri nga bashkëshortët. Për këtë arsye, nuk do të thellohemi më shumë në këtë pikë.

2. Ndarje me shkurorezim, e kjo është tema e jonë:

Shkurorezimi në Islam llogaritet si rrugëdalje nga përçarjet dhe problemet që ndodhin mes dy bashkëshortëve dhe është mënyra e fundit e zgjidhjes së problemeve bashkëshortore.

Zgjidhja e problemeve bashkëshortore fillon dhe kalon nëpër këto faza:

a) Këshilla. Ajo këshillë e cila përmban këshillim, mësim dhe sqarim të gruas se cilat janë obligimet e saj kundrejt burrit të saj, ashtu si dhe sqarimi i obligimeve

[2] Transmeton Muslimi (440), nga hadithi i Ebi Hurejrës.

[3] Transmeton Nesai (5127), nga hadithi i Ebi Hurejrës. Albani e ka konsideruar të saktë në "Sahih el Xhami" (503).

të burrit kundrejt gruas së tij. Këtu duhet theksuar mirë qartësimi i pasojave që rrjedhin nga kundërshtimi i burrit si dhe nga mosruajtja e të drejtave të tij.

b) Largimi nga shtrati. Një largim që i shkakton asaj të ndihet e vetmuar dhe e pashoqëruar, e që aludon për pendim dhe kthim në respekt dhe kryerje të detyrave të saj.

c) Rrahja, por me kusht që të jetë rrahje edukimi dhe frikësimi e jo rrahje hakmarrjeje, me dëmtim të lëkurës apo thyerje të eshtrave.

d) Mbledhja për pajtim dhe diskutim në të cilën merr pjesë një nga familja e saj dhe një nga familja e tij.

E, nëse pas gjithë kësaj që kaloi nuk ka mundësi të zgjidhet ky problem dhe secilit prej tyre i është ngushtuar jeta bashkëshortore, në këtë rast vjen shkurorëzimi duke i dhënë fund kësaj jete bashkëshortore, e cila është shndërruar në ferr në vend që të ishte lumturi, mëshirë, qetësim dhe rehati.

Këto faza që i bëjnë pritë shkurorëzimit, apo që ndoshta e ndalin atë, i ka qartësuar surja en Nisa në dy ajetet në vijim, ku Allahu i Madhëruar thotë:

**"Burrrat janë mbrojtësit dhe mbajtësit e grave, sepse Allahu e ka krijuar njërin palë prej tyre të shquhet mbi tjetrën, e edhe sepse ata shpenzojnë (për t'i mbajtur ato) nga mjetet e tyre të jetesës. Kështu, gratë e drejta janë të bindura me çiltërsi (ndaj Allahut dhe ndaj burrave të tyre) dhe në mungesë të**

**bashkëshortëve të tyre, ruajnë çfarë Allahu i ka urdhëruar ato të ruajnë (dëlirësinë, ndershmërinë dhe pasurinë e bashkëshortëve të tyre etj). Sa për ato gra për të cilat ju shihni sjellje të dobët, në fillim i qortoni, (pastaj) mos pranoni të flini me to, (dhe më në fund) i rrihni ato (lehtë nëse kjo ndikon tek ato), por në qoftë se ato kthehen përsëri te bindja, atëherë mos kërkoni kundër tyre mjete (përçmuese e mërzitëse). Vërtet Allahu është kurdoherë më i Larti, më i Madhi. Në qoftë se keni frikë se prishen marrëdhëniet mes atyre dyve (burrit e gruas), caktoni dy gjykatës, një nga familja e tij dhe një nga familja e saj. Në qoftë se ata të dy dëshirojnë pajtimin, Allahu do të bëjë të mundur pajtimin e tyre. Vërtet Allahu është kurdoherë i Gjithëdituri, gjithnjë në Dijeni të plotë." Nisa: 34-35**

**Përse Islami e ka lënë shkurorëzimin vetëm në dorën e burrit?**

**N**ga ajo që u tha më parë na u bë e qartë se legjitimiteti i shkurorëzimit kishte vend të rëndësishëm, nëse vërtetohet se është shërimi i fundit për zgjidhjen e problemeve bashkëshortore.

Por ka mbetur në këtë pikë edhe një pyetje, e cila ka peshën e vet, nëse përgjigjja e saj kuptohet ashtu si duhet. Ajo pyetje është: Përse Islami e ka lënë shkurorëzimin vetëm në dorën e burrit? Në fakt, gruaja ka diçka në dorë, gjë e

cila as nuk përmendet. Bëhet fjalë për "El Hul'u", i cili është një ndarje ku bashkohet edhe gjyqi dhe nuk veçohet vetëm gruaja në të, siç është e ditur.

Në përgjigje të kësaj pyetjeje thuhet: Përderisa ishte burri ai i cili pagoi prikën (mehrini) dhe të gjitha shpenzimet e tjera në jetën bashkëshortore, po kështu edhe shkurorëzimi është lënë në dorën e tij, pasi ai nuk do të kursejë në ruajtjen e jetës bashkëshortore, për formimin e së cilës ka shpenzuar, por do të jetë më i kujdesshëm që formimi i kësaj baze familjare të vazhdojë të gëzojë qetësi dhe lumturi sa të ketë mundësi për këtë.

E, sikur shkurorëzimi të ishte në dorën e gruas, do të shihnim gjëra si në vijim: Shohim një burrë të ndërtojë një organizatë, pastaj e plotëson me orendi e kujdeset për rezultatet e pritura prej saj. Pastaj shohim që gruaja, e cila është e mangët në logjikë dhe mendim, e shkatërron atë organizatë dhe i prish orenditë e saj për arsye nga më të kotat. Përse? Sepse nuk ka shpenzuar kur është formuar ajo organizatë e ndoshta edhe ka pasur dëshirë të largohet nga ajo që të provojë të tjera.

Jam i bindur se gruaja muslimane e drejtë në gjykim më beson mua para se të më besojë vetë burri, pasi gjendja aktuale dhe gjestet e disa grave argumentojnë atë që folëm më herët, në kohën kur gruaja nuk e ka në dorë shkurorëzimin. E Allahu e di më së miri.

Dhe në mbyllje, o ju vëllezër muslimanë! Të përfaqësojmë Islamin tonë me veprat tona, aq sa të kemi mundësi për këtë dhe jo vetëm me fjalë, sepse Islami është fe e punës dhe e praktikës dhe musliman është ai i cili i nënshtrohet me përkushtim urdhrave të Zotit të tij, Krijuesit të tij, duke i zbatuar ligjet e Tij.

Qëllimi i mirë, nijeti i sinqertë, vepra e mirë dhe mundimi i praktikimit të ligjit të Allahut janë objekt i shikimit nga Allahu i robit të Tij, siç ka thënë i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "Allahu nuk vështron në fizionomitë tuaja e as në pasuritë tuaja, por vështron në zemrat tuaja dhe në veprat tuaja."<sup>[4]</sup>

O vëllezër! Ju keni rastin të punoni për fenë dhe Islamin tuaj, pasi ligji i vendit tuaj ua lejon të jeni shërbëtorë të fesë suaj me të gjithë lirinë. Ju duhet ta kuptoni se kjo liri është mirësi nga Allahu për ju, prandaj ju porosis që ta shfrytëzoni këtë me punë serioze për përhapjen e mësimëve të Islamit tuaj.

E, Allahu pa dyshim se do të jetë me ju, nëse jeni të sinqertë në punët tuaja, sepse Allahu i Madhëruar është me ata të cilët punojnë dhe janë të sinqertë. Atyre u jep sukses dhe i udhëzon në të drejtën.

*Autor: Muhamed el Xhami  
Përshtati: Unejs Murati*

[4]Transmeton Muslimi (2563), nga hadithi i Ebi Hurejrës.

# MËNYRA E TRAJTIMIT TË RISIVE NË FE - BIDATET (II)

Robër të Allahut!

**B**idati është i keq dhe i rrezikshëm për personin, për xhematin dhe fenë dhe bidatçiu është i keq dhe i rrezikshëm për popullin, për xhematin dhe për fenë. Për këtë ka ardhur dënimi nga Allahu për bidatçiun, në mënyrë që të na tregojë neve që të ruhem nga bidati si vijon:

1. Vepra e bidatçiut është e refuzuar dhe Allahu nuk pranon prej tij asnjë punë. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Kush shpik diçka në fenë tonë, e që nuk është në të, ajo është e refuzuar." (Muttefekun alejhi)

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Kush vepron diçka që nuk është në pajtim me çështjen tonë, ajo vepër është e refuzuar." (Transmeton Muslimi) E posaçërisht ata të cilët e duan bidatin, e zbukurojnë te njerëzit dhe e shpërndajnë përmes mjeteve të informimit, ata kanë dështuar dhe janë shkatërruar.

Allahu i madhërishëm thotë: "Thuaj: "A

t'ju tregoj për më të dëshpëruarit në veprat e tyre?" Kehf: 103

2. Bidatçiu është i privuar nga pendimi derisa të jetë në bidatin e tij. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Me të vërtetë Allahu e mbulon pendimin për çdo pasues të bidatit derisa të mos e lërë bidatin e tij." Sahihut tergibi ve terhib: 54

3. Nuk përfshihet në shefatin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

4. Bidatçiu ka mëkatin e vet dhe mëkatin e të gjithë atyre që e bëjnë atë bidat deri në Ditën e Gjykimit.

Allahu i madhërishëm në Kur'an thotë: "(E thonë atë shpifje) Sa për t'i mbartur në Ditën e Gjykimit mëkatet e veta të plota dhe një pjesë të mëkateve të atyre që pa farë arsye i mashtruan dhe i humbën." Nahel: 25

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "...Dhe kush bën një të keqe në Islam, ka mëkatin e vet dhe mëkatin e të gjithëve atyre që e veprojnë një mëkat të tillë duke mos u ndërprerë nga ai

asgjë.” Transmeton Muslimi  
5. Bidatçiu është i mallkuar nga Allahu, nga melekët dhe nga njerëzit në përgjithësi. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Kush shpik në të apo flet diçka të shpikur, për të ka zbritur mallkimi i Allahut, i melekëve dhe i njerëzve në përgjithësi.” Transmeton Buhariu

6. Bidatçiu i shtohet nga bidati i tij vetëm largim nga Allahu. Shiko se çfarë thotë Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem për bidatçiu: “Kryejnë (ua kalojnë) namaz si ju, agjërojnë si ju, mirëpo dalin (largohen) nga Islami ashtu (aq lehtë) siç del shtiza nga harku i saj.” Transmeton Buhariu

Transmetohet nga Ejub Es-Sihtijani se ka thënë: “Sa më shumë zgjerohet pasesi i bidateve (risive) në kërkim, aq më shumë zgjerohet largimi i tij ndaj Allahut.” (Hiljetul evlija: 3/9)

Robër të Allahut!

**B**idati është i keq për personin, xhematin dhe popullin në përgjithësi. Dhe gjendja jonë, nën nënçmim dhe okupim, i ka shkaqet e saj te mëkatet dhe bidatet që u shpikën në fenë e Allahut dhe për këtë arsye obligohet çdo musliman që t'i këshillojë të tjerët që të ruhen nga bidati dhe bidatçinjtë duke kërkuar nga kjo vepër shpërblim nga Allahu.

Ejani të njohim dhe të mësojmë besimin e sinkertë në urrejtjen e bidatit nga Abdullah Ibën Mesudi, Allahu qoftë i

kënaqur me të, nga i cili marrim shembuj dhe mësim të larta.

Robër të Allahut!

Abdullah Ibën Mesudi është ai që ka thënë: “Pasoni dhe mos shpikni, se kjo ju mjafton.”

Abdullah Ibën Mesudi është ai që ka thënë: “Praktikimi i pakët në sunnet është më i mirë sesa zgjerimi në bidate.”

Sahihut tergibi vet terhib:41

Abdullah Ibën Mesudi është ai të cilit i ka thënë Ebu Musa el-Esharij: “O Ebu Abdurrahman, pak më parë kam parë në xhami një gjë të urryer.” Abdull-llah Ibën Mes'udi i tha: “Çfarë ishte ajo?”

Ebu Musa el-Esharij i tha: “Nëse jeton, do ta shikosh edhe ti. Kam parë në xhami një popull të ulur në rreth duke pritur namazin dhe në çdo rreth nga një njeri dhe në duar mbanin gurë (sende) dhe u thoshte: “Kebiru 100 herë (merrni tekbire thoni Allahu ekber)”, dhe merrnin tekbire 100 herë. “Helilu 100 herë (bëni tahlil, thoni la ilahe il-la lllah)” dhe bënin. “Sebihi 100 herë (bëni tesbih subhanallah)”, dhe bënin.” Abdullah Ibën Mesudi: “Çfarë u the atyre?”

Ebu Musa el-Esharij: “Nuk u thashë asgjë duke pritur urdhrin dhe mendimin tënd.”

Abdullah Ibën Mesudi: “A nuk i urdhërova që t'i numërojnë mëkatet e tyre dhe nuk i garantova se të mirat nuk u humbin?”

Pastaj kemi shkuar bashkë me të derisa kemi arritur në xhaminë ku ishte ai

rreth që bënte ibadet në atë mënyrë dhe Abdullah Ibën Mesudi qëndroi para tyre duke thënë: “Ç’është kjo që po veproni?”

Iu përgjigjën: “O Ebu Abdurrahman! Janë gurë (sende) me të cilët po numërojmë tekbiret, tahlilet dhe tesbihet.”

Abdullah Ibën Mesudi u tha: “Numëroni mëkatet tuaja, se unë ju garantoj se nuk ju humb asgjë nga të mirat që keni bërë. O të mjerë! O umeti (populli) i Muhamedit! Sa i shpejtë është shkatërrimi, humbja juaj!

Ja ku janë shokët e Pejgamberit tuaj gjallë. Rrobat e tij ende nuk janë tharë, enët e tij ende nuk janë thyer. Pasha Atë në Dorën e të Cilit është jeta ime, a mos jeni ju popull më i dashur dhe më i udhëzuar se populli i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem apo jeni në derë të shkatërrimit?”

Ata iu përgjigjën: “Vallahi, o Ebu Abdurrahman! Nuk kemi dashur nga kjo vetëm se mirë.”

Abdullah Ibën Mesudi u tha: “Sa nga ata që duan të mirën, mirëpo nuk ia qëllojnë! Me të vërtetë Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Me të vërtetë një popull lexon Kur’an, mirëpo leximi i tyre nuk arrin as deri te fyti i tyre.” Vallahi, nuk e di, ndoshta shumica nga ju jeni prej tyre.” Pastaj është larguar nga ata.

Amër ibn Selemeh: “Kemi parë shumicën e atyre që kanë qenë në atë rreth duke kundërshtuar në ditën e Nehranit

me havarixhët. Po, vallahi, nuk ka shpikur njeri një bidat, vetëm se është lejuar shpata ndaj tij.”

Robër të Allahut!

**M**ësimet, dobitë, këshillat që merren nga qëndrimi i Abdullah ibën Mesudit janë të shumta. Ndër to përmendim:

E para: Vepra nuk pranohet tek Allahu vetëm pasi të plotësohen dy kushte. Kushti i parë është sinqeriteti ndaj Allahut të madhërisëm në vepër. Kushti i dytë është pajtueshmëria me Sunnetin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Nuk mjafton për pranimin e një vepre vetëm sinqeriteti ndaj Allahut duke mos qenë në pajtim me Sunnetin. Robi i Allahut, para se të kryejë një vepër, duhet t’i bëjë vetes dy pyetje. Pyetja e parë: Për kë e bën veprën? Përgjigjja: Me sinqeritet për Allahun.

Dhe pyetja e dytë: Si e bën? Përgjigjja: Sipas Sunnetit të Muhamedit.

E dyta: Bidati është shkak i humbjes pasi e bën njeriun të largohet nga Sunneti. E, nëse njeriu largohet nga një sunnet, vetëm se ka humbur në një humnerë të madhe. Nuk kemi hasur në veprimin e bidatçiu të bidatit që të mos jetë larguar nga një sunnet, i cili i kundërvihet këtij bidati. Për këtë ka thënë Ibën Mesudi: “Nëse e lini, largoheni nga Sunneti i të Dërguarit, do të humbni.”

Ruaju nga shoqërimi i pasuesit të

bidatit, se shoqërimi tij është sëmundje e zemrës.

E treta, nënvlerësimi i çështjes së bidatit është rrugë që të shpie në dyfytyrësi dhe mëkate, në rebelizëm nga xhemati i muslimanëve. Shikoni se si bidatçinjtë e kohës së kaluar dhe të kohës sonë e dëmtuan umetin musliman.

Bidati i havarixhëve çfarë dëmi u solli muslimanëve, o robër të Allahut?!

Bidati i mu'tezilëve çfarë dëmi u solli muslimanëve, o robër të Allahut?!

Bidati i murxh'ive çfarë dëmi u solli muslimanëve, o robër të Allahut?!

Bidati i shiitëve (dervishëve) çfarë dëmi u solli muslimanëve, o robër të Allahut?!

Bidati i hizbijve (partiakëve, ndarjes në parti e grupime), me urrejtjen që e ndau popullin, çfarë dëmi u solli muslimanëve, o robër të Allahut?!

Çfarë na ndalon ne që sot të jemi një trup i bashkuar, duke qenë se të gjithë po adhurojmë një Zot dhe po pasojmë një të Dërguar dhe kemi një libër (Kur'anin)? Çfarë na ndalon që të bashkohemi dhe të jemi trup i vetëm dhe të jemi saf i përbashkët?

Me të vërtetë na ndalon bidati, mëkati! Dhe mos paramendoni se fitorja vjen nga duart e bidatçinjve, lidhini zemrat tuaja me Allahun dhe kërkoni fitore nga Allahu. Nuk ka fitore përveç fitores së Allahut. Allahu në Kur'an thotë: **“O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) Allahun, Ai ju ndihmon ju dhe ju forcon këmbët tuaja.”** Muhammed: 7

Qëllimi i mirë nuk e bën të mirë veprën

e kotë.

Shumë njerëz mendojnë se afrohen tek Allahu me bidatin e tyre duke thënë se qëllimi i tyre është i mirë, mirëpo qëllimi i mirë nuk e bën të kotën të mirë e as veprimin e ndaluar të lejuar, përveç asaj që është në pëlqim me Sunnetin. Allahu ka thënë për krijesat më të urrejta: **“...pse ata (të humburit) shejtanët i morën për miq e megjithatë mendonin se ishin në rrugë të drejtë.”** E'araf: 30

Jemi të obliguar të mësojmë, të rikthehemi tek Allahu, t'i respektojmë ligjet e Allahut dhe nëse e bëjmë, atëherë vallahi Ai do të na ndihmojë të fitojmë kundër nefsit, që na cyt për të këqija, dhe do të fitojmë ndaj shejtanëve njerëz dhe xhinë.

Sepse kur Allahu dëshiron diçka, vetëm thotë: **“Bëhu”** dhe ajo bëhet.

O Allah, riktheji muslimanët në librin Tënd dhe në Sunnetin e të Dërguarit Tënd me një rikthim të shkëlqyer!

*Hytbe e ligjëruar nga hoxhë Ebu Islam, Salih bin Taha AbdulVahid, imam dhe hatib në një nga xhamitë e njohura të Jordanisë.*

*Përshtati: Unejs Murati*

# VENDIMI I ZEKATIT NË ISLAM

*Pyetja 1: Hoxhë i nderuar, cili është vendimi për zekatin në Islam?*

Përgjigja: Zekati është një ndër pesë shtyllat në të cilat mbështetet Islami, duke u bazuar në fjalën e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem: "Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: mbi dëshminë se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, në faljen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimin e Ramazanit dhe haxhi në shtëpinë e Allahut, Qaben."<sup>[1]</sup>

Pra, zekati është obligim me konsensusin e të gjithë muslimanëve dhe kush e mohon obligueshmërinë e tij ka bërë kufër. Vetëm nëse është ndonjë i ri në Islam apo është rritur në malësi të largët nga dija dhe dijetarët, në këtë rast arsyetohet, por duhet t'i jepet dije. E, nëse pas tërë kësaj insiston në të, atëherë ai ka mohuar si renegat (i dalë nga feja).

Ndërsa kush e pengon dhënien e zekatit nga korracia dhe asgjësimi i tij, për këtë ka kundërthënie në mesin e dijetarëve. Disa prej tyre kanë thënë se ai ka mohuar dhe kjo është njëra prej pikëpamjeve të transmetuara nga Imam Ahmedi, por disa të tjerë kanë thënë se ai nuk ka mohuar dhe kjo është pikëpamja e qëlluar, mirëpo ka bërë një mëkat të madh shumë dhe argumenti se ai nuk ka mohuar është hadithi i Ebu Hurejrës, se Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem pasi ka përmendur ndëshkimin për ata që e ndalojnë dhënien e zekatit të arit dhe të argjendit, ka thënë: "...derisa të gjykohet mes robërve dhe robi sheh rrugën e tij, ose për në xhenet ose për në zjarr."<sup>[2]</sup>

Që do të thotë se nëse ka mundësi ta shohë rrugën e tij për në xhenet, atëherë ai nuk është jobesimtar, sepse jobesimtari nuk ka mundësi ta shohë rrugën e tij për në xhenet.

Mirëpo ai që nuk e jep zekatin nga përtacia dhe neglizhenca, ai ka bërë mëkat të madh, që Allahu e ka cekur në fjalën e Tij: **"Dhe le të mos mendojnë ata të cilët me zili mbajnë dhe nuk japin nga ato gjëra që u ka dhuruar Allahu nga Begatitë e Tij, se kjo është mire për ta** (dhe në këtë mënyrë ata nuk paguajnë detyrimin e zekatit). **Përkundrazi, do të jetë akoma më keq për ta; gjërat që ata nga zilia nuk i jepnin do t'u varen si kular në qafë në Ditën e Ringjalljes. Dhe Allahut i përket trashëgimia e qiejve dhe e tokës, dhe Allahu është i mirënjohur për gjithçka që ju veproni."** Ali Imran: 180

Dhe në fjalën e Tij: **"Dhe ata atyre që grumbullojnë pasuri në ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë në rrugën e Allahut, përgëzoj ata me dënim të dhimbshëm. Ditën kur ai (thesari i tyre me ar dhe argjend i papastruar me zekat) do të nxehet fort në Zjarrin e xhehenemit dhe me të do të damkoset balli i tyre, krahët e tyre dhe shpina,** (duke u thënë): **"Ky është thesari të cilin ju e grumbulluat (dhe e varrosët) për veten tuaj. Tani shijoni (thesaret) që grumbulluat."** Tevbe: 34-35 Prandaj, njeriu duhet ta falënderojë Allahun e të jetë mirënjohës për pasurinë me të cilën Ai e ka begatuar dhe le ta japë zekatin, në mënyrë që Allahu t'i japë atij bereqet në pasurinë e tij. Allahu është dhuruesi i sukseseve.

[1] Transmeton Buhariu, nga libri i Imanit, kapitulli: Lutja juaj është besimi juaj, nr. 8; Muslimi nga libri i Imanit po ashtu, kapitulli: Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla, nr. 16.

[2] Transmeton Muslimi, libri i Zekatit, kapitulli: Mëkati i pengimit të dhënies së zekatit, nr. 987.

# PERFORMANCAT E ZEKATIT NË SHOQËRI DHE EKONOMI

*Pyetja (2): Cilat janë performancat e zekatit në shoqëri dhe ekonomi?*

Përgjigjja: Performancat e zekatit në shoqëri dhe në ekonominë islame janë shumë evidente, në të shfaqet barazia e të varfërve dhe interesi kolektiv, që doemos vërehet në dhënien e zekatit, siç thotë edhe Allahu i Lartësuar për grupet të cilave u jepet zekati: **"Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për të tërhequr zemrat e atyre që janë të prirë drejt Islamit, për lirimin e skllevërve, për të rënduarit nga borgjet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve."** Tevbe: 60

Në këto tetë grupe ka që marrin prej zekatit për ta kryer një nevojë, dikush merr që të përmbushë një interes të muslimanëve; për shembull fukarenjtë, të mjerët dhe borxhlinjtë e marrin atë për vete, kurse dikush tjetër e merr për nevojat e njerëzve, si për shembull ai që kujdeset për të pajtuar njerëzit, ata që punojnë në mbledhjen e zekatit dhe ata që luftojnë në rrugë të Allahut.

Tani që e kuptuam se me shpërndarjen e zekatit ndaj këtyre tetë grupeve arrihet interes i veçantë i atyre që u jepet dhe interesi i përgjithshëm për muslimanët në përgjithësi, atëherë e kuptojmë se sa e madhe është dobia e zekatit në shoqëri.

Kurse dobia ekonomike e zekatit është se bëhet ndarja e pasurive mes të pasurve dhe të varfërve, duke marrë prej pasurisë së të pasurve një sasi që t'u shpërndahet të varfërve. Kjo shpërndarje e pasurive bëhet në mënyrë që mos

të ketë grumbullim pasurie vetëm në një tabor njerëzish dhe përhapje të varfërisë.

Prej dobive të tjera të dhënies së zekatit në shoqëri është edhe bashkimi i zemrave, ngase kur të varfrit shohin se të pasurit po i ndihmojnë me pasuri dhe e japin zekatin për ta, pasi është obligim për ta nga Allahu, do t'i duan të pasurit, shoqërohen me ta dhe shpresojnë vazhdimisht nga zekati dhe shpenzimi i të pasurve.

Nëse të pasurit do të tregoheshin koprracë në zekat dhe qëllimi i tyre do të kishte qenë vetëm grumbullimi i pasurisë, kjo do të kishte mbjellë armiqësi dhe zili në zemrat e të varfërve dhe në këtë aludon fundi i ajeteve fisnike, në të cilat flitet për grupet që meritojnë zekatin, ku Allahu i Lartësuar thotë: **"Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtetë, Allahu është i Gjithëditur, më i urti Gjithëgjykues."** Tevbe : 60

*Shkëputur nga libri "Fikhul-Ibadat"  
të Muhamed Salih Utbejmin  
Përshtati: Zejd Haziri*

# MUHAMED IBËN SALIH EL-UTHEJMIN

## JETA DHE VEPRA E TIJ

**D**ijetari i nderuar, Allahu e mëshiroftë, lindi në qytetin Unejzë më 27 Ramazan të vitit 1347h në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Kur'anin e mësoi përmendësh që në fëmijëri e më pas e vazhdoi kërkimin e diturisë duke filluar nga shejhu Abdurr-Rahman ibën Nasër es-Saadi, Allahu e mëshiroftë. Nga ai mësoi teuhidin, tefsirin, sirën (historinë e Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem), hadithin, fikhun, usuli fikhun, faraidin (të drejtën e trashëgimisë), terminologjinë e hadithit, nahvin (sintaksën arabe), sarfin (morfologjinë arabe). Pra, mund të themi se Abdurr-Rahman ibën Nasër es-Saadi, Allahu e mëshiroftë, është hoxha i parë i tij, pasi mori prej tij dituri më shumë se prej çdokujt tjetër.

Kur dijetari Abdurr-Rahman ibën Alij, Allahu e mëshiroftë, ishte gjykatës në qytetin e Unejzës, lexoi tek ai libra të shkencës së Trashëgimisë. Të dijetari Abdurr-Rrez-zak el-Afifi, Allahu e mëshiroftë, lexoi për disiplina të tjera të dijes.

Kur u hap instituti shkencor në Riad, disa shokë i sugjeruan të shkonte atje, prandaj ai kërkoi nga mësuesi i tij, Abdurr-Rahman ibën Nasër es-Saadi, Allahu e mëshiroftë, që ta lejonte të shkonte. Pasi mori leje prej tij, iu bashkua këtij instituti shkencor për dy vite (1372-1373h).

Në këtë institut shkencor përfitoi nga shumë dijetarë, të cilët ishin mësimdhënës aty. Ndër ta mund të përmendim komentuesin e njohur të Kur'anit, Muhamed Emin esh-Shenkiti, dijetarin AbdulAziz ibën Nasër ibën Reshid, dijetarin AbdurrRahman el-Ifriki, Allahu i mëshiroftë.

Gjatë kësaj kohe kontaktoi edhe me dijetarin e nderuar AbdulAziz ibën Baz, Allahu e mëshiroftë. Lexoi tek ai në xhami prej librit Sahihul-Buhari, disa shkrime të Hoxhës së Islamit Ibën Tejmijes si dhe përfitoi nga ai në lëminë e hadithit dhe të fikhut. AbdulAziz ibën Bazi, Allahu e mëshiroftë, llogaritet mësuesi i dytë i tij.

Në vitin 1374h, kthehet në vendlindje dhe fillon të marrë dije nga mësuesi i parë i tij, AbdurrRahman ibën Nasër es-Seadi, Allahu e mëshiroftë. Gjithashtu vazhdon mësimet në Fakultetin e Sheriatit, i cili më pas u bë pjesë e Universitetit Islamik "Imam Muhamed ibën Saud", derisa arriti të marrë diplomën e lartë.

Me iniciativën e mësuesit të tij, filloi të mbante ligjërata në xhaminë e madhe të Unejzës në vitin 1370h. Mësuesi i tij ia dha këtë sugjerim duke pasur parasysh zgjuarsinë dhe mendjemprehtësinë e tij.

Kur përfundoi mësimet në institutin shkencor në Riad, u punësua si mësimdhënës në institutin shkencor në vendlindje. Ishte viti

1374h.

Pas vdekjes së mësuesit të tij, AbdurrRahman ibën Nasër es-Seadit, Allahu e mëshiroftë, në vitin 1376 (h) bëhet imam në Xhaminë e Madhe të Unejzës dhe merr përsipër mësime në Bibliotekën Kombëtare të Unejzës, e cila ishte në kuadër të xhamisë, që ishte themeluar nga mësuesi i tij në vitin 1359h.

Pasi numri i studentëve u shtua dhe biblioteka nuk ishte e mjaftueshme për ta, filloi të jepte ligjërata në të njëjtën xhami ku shërbente si imam. Studentët e tij, të ardhur nga qytete të ndryshme të Arabisë Saudite dhe jashtë saj, ishin me qindra. Ata jo vetëm që i dëgjonin ligjëratat e tij, por edhe i mësonin ato. Ai e vazhdoi punën e tij si mësime në xhaminë e tij derisa vdiq, Allahu e mëshiroftë.

Ky dijetar, Allahu e mëshiroftë, e vazhdoi punën e tij si mësime në institutin shkencor prej vitit 1374 deri më 1398h, meqë u transferua në Fakultetin e Sheriatit dhe të Bazave të Fesë në qytetin e Kasimit, i cili ishte në kuadër të Universitetit Islamik "Imam Muhamed ibën Saud". Ai vazhdoi të ishte mësime në këtë fakultet derisa ndërroi jetë, Allahu e mëshiroftë.

Ai mbante ligjërata në të dy haremet gjatë kohës së haxhit dhe të ramazanit, në Haremin e Mekës (në Qabe) dhe në atë të Medinës (në xhaminë e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem). Po ashtu mbante ligjërata edhe gjatë pushimeve verore që nga viti 1402h e derisa ndërroi jetë, Allahu e mëshiroftë.

Ishte i angazhuar edhe në shumë veprimtari të tjera. Ishte anëtar i Këshillit Shkencor pranë Universitetit Islamik "Imam Muhamed ibën Saud" gjatë dy viteve akademike 1398/1399h dhe 1399/1400h. Ishte anëtar i Akademisë së Dijetarëve të

Mëdhenj në Mbretërinë e Arabisë Saudite prej vitit 1407h e derisa ndërroi jetë. Ishte udhëheqës i kryesisë së shoqatës për mësime e Kur'anit Famëlartë përmendësh në Unejzë që nga themelimi i saj në vitin 1405h e derisa ndërroi jetë. Mbante ligjërata të ndryshme brenda Mbretërisë Saudite me të gjitha shtresat e njerëzve si dhe ligjërata të tjera në shumë vende jashtë Mbretërisë Saudite përmes telefonit.

Dijetari i nderuar, Allahu e mëshiroftë, ishte i angazhuar edhe me shumë punë të tjera në fusha të ndryshme si dhe ndihmonte çdokë, pa marrë parasysh racën apo kombin.

Disa nga librat e tij:

- 1) *Sherhul-Akidetul-Vasitij-je* (në lëminë e besimit)
- 2) *Akidetu Ehlu-Sunneti vel-Xhemaah* (në lëminë e besimit)
- 3) *Sherhul-Mumti Ala zadil-Mustakni* (në lëminë e fikhut)
- 4) *Sifetu salatin-Nebijji sal-lAllahu alejhi ve sel-lem* (në lëminë e fikhut)
- 5) *Mexhmu'ul-fetava* (ku janë mbledhur të gjitha fetvatë e tij dhe artikujt që ka shkruar).

## Vdekja e tij

Ndërroi jetë në qytetin e Xhides para namazit të akshamit, të mërkurën më 15 sheval të vitit 1421h. Namazi i xhenazes iu fal të nesërmen në haremin e Mekës (në Qabe), pas namazit të ikindisë. Në varrimin e tij morën pjesë mijëra njerëz nga të gjitha shtresat.

Në fund, e lusim Allahun e Lartësuar me emrat e Tij të mirë dhe cilësitë e Tij të larta që ta mëshirojë shejhun tonë dhe t'ia rrisë gradat në xhenet!

*Përmbledhi dhe përshtati: Sabahudin Selimi*

# KREMTIMI I NATËS SË ISRASË DHE MIRAXHIT

**M**e të vërtetë që Israja dhe Miraxhi janë prej argumenteve të Allahut të Madhëruar, argument për vërtetimin e pejgamberllëkut të Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem dhe aludim për gradën e çmuar që ka Pejgamberi tek Allahu i Madhëri. Gjithashtu është argument për plotfuqinë e Allahut dhe Lartësinë e Tij mbi të gjitha krijesat. Allahu i Lartësuar thotë: **“I pa të meta është Lartmadhëria e Tij, që robin e Vet e kaloi (ngriti) në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për të ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit) dhe shikues (i punëve të Muhamedit).”** Isra: 1

Është vërtetuar nga Muhamedi sal-Allahu alejhi ve sel-lem se ai me të vërtetë është ngritur në qiej dhe i janë hapur dyert, derisa është ndalur në qiellin e shtatë dhe ka komunikuar me Allahun e Madhëri. Ashtu siç ka dashur Ai. Dhe aty janë bërë obligim namazet për këtë umet. Në fillim, Allahu i Madhëri ka obliguar me pesëdhjetë kohë namaz dhe ai e ka vazhduar qëndrimin në qiell duke kërkuar nga Allahu i Madhëri lehtësim, derisa Ai ia lehtësoi umetit në pesë kohë në ditë. Mirëpo shpërblimi i pesë kohëve është sa pesëdhjetë, për arsye se të mirat shumëfishohen nga dhjetë shpërblime e më shumë herë për atë që do Allahu. Allahut i takon lavdërimi dhe falënderimi për të gjitha mirësitë!

Kjo natë, në të cilën ka ndodhur Israja dhe Miraxhi, në hadithe autentike nuk është cituar se cila natë është dhe nuk ka ndodhur as në mua-

jin Rexheb e as në muajt e tjerë. Çdo gjë që është e transmetuar për këtë natë (d.m.th. për caktimin se në cilën natë dhe muaj ka ndodhur, pra kremtimi i saj) nuk është e vërtetë dhe nuk është e njohur tek dijetarët e hadithit. Pa dyshim që moscaktimi i kësaj nate është urtësi e Allahut, po edhe sikur ta caktonte, nuk do t'u lejohej muslimanëve që ta veçojnë atë me diçka prej adhurimit dhe për këtë arsye edhe nuk u lejohet festimi i saj, pasi Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem nuk e ka praktikuar dhe as sahabët e tij nuk e kanë veçuar me diçka të veçantë.

Po të ishte kremtimi i festave gjë e lejuar, këtë do ta kishte qartësuar Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem për popullin ose me fjalë ose me vepër. Sikur të kishte ndodhur kjo, do të ishte e njohur dhe do ta kishin transmetuar tek ne sahabët, kur dihet që ata kanë transmetuar nga Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem atë që ka qenë e nevojshme për popullin dhe nuk kanë lënë pas dore asgjë nga feja. Ata kanë nxituar para nesh gjithmonë me punë të mira dhe sikur të ishte kremtimi i kësaj nate i lejuar dhe pjesë e fesë, këtë do ta kishin vepruar ata para nesh. Ne jemi të bindur se Muhamedi sal-Allahu alejhi ve sel-lem është këshilluesi më i mirë për njerëzit, e kumtoi mesazhin në shkallën më të lartë dhe e kreu misionin që kishte nga Allahu.

Sikur të ishte madhërimi i kësaj nate dhe kremtimi i saj pjesë e fesë islame, nuk do të ngurronte ta bënte këtë i Dërguari sal-Allahu alejhi ve sel-lem e as nuk do ta asgjësonte, mirëpo kur ka ndodhur kjo gjë e tillë? Pra, mësuam se kjo festë (Israja dhe Miraxhi) nuk është nga feja e

pastër islame.

Allahu e plotësoi fenë për këtë umet dhe e përsosi në formën më të mirë, duke e refuzuar atë që nuk është nga Islami i pastër dhe atë që Allahu nuk e lejoi për umetin tonë. Allahu në Kuranin Famëlartë thotë: **“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush, dhe zgjodha që islami të jetë feja juaj.”** Maide 3, dhe ajeti tjetër: **“A kanë ata idhuj, të cilët u kanë caktuar një fe që nuk e ka lejuar Allahu?! Sikur mos të kishte qenë Fjala e vendimit të më parshëm, ata do të ishin gjykuar menjëherë. Për keqbërësit është përgaditur një denim i dhembshëm.”** Shura 21

Është vërtetuar nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem se ka thënë: “Kujdes nga risitë!”, duke treguar se kjo është humbje dhe e ka porositur umetin të largohet nga ato.

Autentikisht transmetohet nga Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Kush vepron diçka që nuk është në pajtim me çështjen (fenë) tonë, ajo vepër është e refuzuar.” Ndërsa nga Xhabiri, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmetohet se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë në ligjëratën e së premtës: “Ruajuni nga gjërat e shpikura, se çdo e shpikur është risi e çdo risi është humbje.”

Nga Irbad ibën Sarijeh, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmetohet se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem na këshilloi me një këshillë tepër të prekshme, saqë na u drodhën zemrat dhe sytë na lotuan. Dhe ne i thamë: “O i Dërguari i Allahut, sikur të ishte kjo këshillë lamtumirëse!”

Ai tha: “Ju këshilloj të keni frikë Allahun dhe t'i dëgjoni e respektoni udhëheqësit tuaj, edhe nëse ky udhëheqës i caktuar për ju të jetë rob nga Etiopia. Dhe kushdo që jeton nga ju më gjatë, do të përjetojë divergjenca të mëdha, por unë ju këshilloj që të kapeni për Sunetin tim dhe të hulefau rrashidinëve të udhëzuar pas meje. Atëherë kapuni për të (Sunetin tim) me dhëmballë dhe ruajuni nga gjërat e shpikura, se me të vërtetë ato janë risi e çdo risi është

humbje.”

Kremtimi i këtyre festave është përngjasim me armiqtë e fesë islame, ithtarët e librit, të cilët shpikën dhe shtuan në fenë e tyre duke futur risi të cilat nuk ua lejonte Allahu i Madhërishëm, duke u munduar kështu të shpikin mangësi në fenë islame dhe ta ofendojnë me pretekst se Islami nuk është fe e plotësuar. Nga kjo vërehet qartë se kjo është një katastrofë e madhe (shkatërrim), një gjë e urryer dhe kundërvënie ndaj thënies së Allahut: “Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush, dhe zgjodha që islami të jetë feja juaj.” Gjithashtu është kundërshtim i haditheve të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, prandaj duhet të kemi kujdes të posaçëm nga risitë dhe të largohemi prej tyre. Së fundi, shpresoj që argumentet e përmendura do t'i mjaftojnë muslimanit që dëshiron të ndjekë të vërtetën dhe të urrejë risitë, domethënë kremtimin e natës së Israsë dhe Miraxhit. Muslimani duhet të ketë kujdes nga kjo për arsye se nuk është aspak nga feja e Allahut. Allahu na ka obliguar që t'i këshillojmë muslimanët dhe t'ua qartësojmë atyre fenë dhe na e bëri haram (ndaloj) fshehjen e diturisë.

Për këtë, e pamë të arsyeshme që t'ua kumtojmë vëllezërve muslimanë këtë vërejtje kundër kësaj risie, pasi kjo risi është e përhapur në shumicën e vendeve islame dhe disa muslimanë mendojnë se është prej fesë së pastër.

Vetëm Allahu është mbikëqyrës dhe rregullues i gjendjes së muslimanëve në përgjithësi. E lusim Atë të na forcojë në të kuptuarit e fesë së vërtetë dhe të na e bëjë të mundur mua dhe juve që të kapemi pas së vërtetës, të na forcojë në të dhe të na largojë nga risitë! Me të vërtetë Ai i përgjigjet lutjes dhe është pranuesi më i mirë. Përsëendetjet qofshin për të Dërguarin e Tij, për shokët e tij dhe për pasuesit e tij deri në Ditën e Gjykimit.

*Autor: Abdul Aziz bin Baz  
Përshtati: Unejs Murati*